



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 426 Akti

Nr. 336 Vendimi
Tiranë, më 15.1.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 11.1.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bardhok Lleshi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shpresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi çështjen, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V Ë R E N :

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Bardhok Lleshi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Bardhok Lleshi, u shortua në datën 16.12.2019. Relatore e çështjes u zgjodh, sipas shortit, komisionere Valbona Sanxhaktari dhe anëtarë komisionerët Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesues për këtë çështje komisionerin Olsi Komici. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova.

- 3.** Në datën 8.1.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.
- 4.** Në datën 7.2.2020 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
- 5.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- 6.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
- 7.** Në datën 19.11.2020, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura për kriterin e pasurisë dhe në vijim vendosi mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Bardhok Lleshi, vetëm për kriterin e pasurisë dhe, në bazë të nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
- 8.** Komisioni njoftoi në datën 19.11.2020, nëpërmjet postës elektronike, subjektin e rivlerësimit, z. Bardhok Lleshi, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, si dhe iu bënë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit të paraqitura nga Komisioni.
- 9.** Subjekti ka kërkuar shtesë të afatit lidhur me dorëzimin e parashtrimeve lidhur me rezultatet e hetimit, kërkesë kjo e pranuar nga Komisioni dhe njoftuar subjektin e rivlerësimit.
- 10.** Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe në datën 19.12.2020 dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij për gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit. Sëbashku me shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit riçeljen e hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë, si dhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, kontrollin e figurës dhe aftësitë profesionale.
- 11.** Komisioni, pasi ka marrë provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ka pranuar dhe administruar të gjitha provat shkresore të paraqitura. Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se nuk ka pranuar kërkesën e tij për riçeljen e hetimit administrativ, pasi deri në këtë fazë të hetimit konstatohen problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin i ka kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nëse subjekti me shpjegimet dhe me provat e paraqitura do të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, trupi gjykues, pasi t’i vlerësojë ato, do të vendosë lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit.
- 12.** Në vijim, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit, z. Bardhok Lleshi, në seancë dëgjimore në datën 11.1.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve.
- 13.** Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 11.1.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në këtë seancë dëgjimore. Ai kërkoi të përfaqësohej së bashku edhe me përfaqësuesin ligjor, z. Gedeon Dudushi, deklaruar përfaqësimi në seancë.
- 14.** Me fillimin e seancës, përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit i paraqiti një kërkesë trupit gjykues duke kërkuar riçeljen e hetimit për kriterin e pasurisë dhe riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera të vlerësimit, atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

15. Trupi gjykues i Komisionit u tërhoq për të vlerësuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit, paraqitur në seancë nga përfaqësuesi i tij ligjor, të cilën e gjeti të përsëritur me atë të paraqitur në vijim të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën në dhomë këshillimi, njoftoi subjektin e rivlerësimit se nuk e pranon atë, deri në këtë moment të procesit të rivlerësimit, duke vijuar me seancën dëgjimore.

16. Përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit paraqiti në vijim kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues për njëanshmëri. Trupi gjykues i Komisionit u tërhoq, duke ndërprerë seancën dëgjimore për t'i dhënë mundësinë një trupe tjetër gjykuese të shqyrtojë dhe vlerësojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, paraqitur nga përfaqësuesi i tij ligjor për përjashtimin e trupit gjykues. Trupi gjykues i Komisionit i la afat kërkuesit të paraqesë kërkesën e tij me shkrim, brenda ditës, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

17. Trupi gjykues, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i zgjedhur me short për shqyrtimin e kërkesës së subjektit Bardhok Lleshi për përjashtimin e trupit gjykues nga hetimi dhe vlerësimi i çështjes, pasi ka diskutuar çështjen ka vendosur mospranimin e kërkesës duke i njoftuar subjektin të rivlerësimit vendimin e tij.

18. Më tej, Komisioni ftoi subjektin e rivlerësimit për të vijuar me seancën dëgjimore në datën 13.1.2021, ora 12:30, në ambientet e Pallatit të Koncerteve. Në këtë seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Bardhok Lleshi, nuk ishte i pranishëm, por ishte i pranishëm përfaqësuesi i tij ligjor z. Gedeon Dudushi, i cili shpjegoi lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës.

19. Në përfundim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit kërkoi që të riçelet hetimi administrativ për të tri kriteret, si dhe në rast se kjo kërkesë nuk merret parasysht kërkoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie*, në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

21. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)¹ ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Bardhok Lleshi ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

22. Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017², të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi.

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë: 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

²“41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

23. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

24. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Pasuria tokë arë, me sip. 8.320 m², me nr. pasurie ***, e ndodhur në Dritas, Tiranë, e regjistruar në datën 11.7.2002, sipas Kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.7.2002, e blerë faktikisht në vitin 1998. Vlera: 832.000 (tetëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim për këtë pasuri: të ardhurat nga emigracioni në vitet 1991 – 1996 në Athinë, Greqi.

1.1 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklarimin fillestar në vitin 2004, si “tokë-arë me sipërfaqe 8.320 m², me vendndodhje në Tapizë, me vlerë 832.000 (tetëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë dhe datë krijimi 2.7.2002. Pjesa takuese: 100 %”.

1.2 Në DPV-në e vitit 2006 subjekti deklaroi se pagesa për pasurinë tokë arë, me sip. 8.320 m² është bërë në vitin 1997, por kontrata është lidhur në vitin 2002.

1.3 Subjekti deklaroi në deklaratën *Vetting* si datë krijimi datën 11.7.2002 dhe blerjen faktike në vitin 1998, duke përcjellë në funksion të deklarimit Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.7.2002, para noterit publik Xh. H., e nënshkruar midis palës shitëse B. K., N. K., L. K., S. K., A. K. dhe palës blerëse Bardhok Lleshi, me objekt: shitjen e pasurisë “arë” me sip. 8.320 m², me vendndodhje në Dritas, Tiranë, në pronësi të palës shitëse, e cila e kishte fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”. Çmimi i shitjes është përcaktuar në vlerën 832.000 (tetëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale përpara nënshkrimit të kontratës.

1.4 ASHK⁵-ja Rurale 1 konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit figurojnë e regjistruar pasuria “arë me sip. 8.320 m²” me nr. pasurie *** dhe z. k. ***, me vendndodhje në Tapizë, Tiranë, regjistruar në emër të subjektit në bazë të Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.7.2002.

1.5 Nga dokumentacioni bashkëlidhur shkresës së ASHK-së Rurale 1 rezultoi se kjo pasuri është bllokuar në datën 9.4.2010, në favor të “ProCredit Bank” për shumën 70.000 (shtatëdhjetë mijë) euro dhe është zhbllokuar në datën 15.6.2011. Në vijim është bllokuar në favor të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., në datën 24.11.2011, për shumën 5.000.000 (pesë milionë) lekë. Nga korrespondenca me BKT-në rezultoi se subjekti është garantor në kredinë e marrë nga shtetasi B. Y. D. – hua afatgjatë për të pastrehët dhe garantor për shtetasin S. M. – hua afatgjatë për shtëpi.

1.6 Subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këto bllokime të “ProCredit Bank” për të cilat përgjigjet se pronat janë bllokuar për vëllain e tij dhe për kolegun Behar Dibra, prokuror pranë Prokurorisë Speciale (SPAK) me të cilin ka punuar për 5 vjet në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë. Vendosja e këtyre pronave kolateral në të dyja rastet nuk është bërë kundrejt ndonjë shpërblimi dhe nuk ka qenë në konflikt interesi. Ndërsa, lidhur me mosdeklarimin, ai shprehet se nuk ka pasur detyrim ligjor për t’i deklaruar, pasi dorëzania është një marrëdhënie besimi, në rastin konkret pa asnjë përfitim financiar apo përfitim të ndonjë natyre tjetër.

1.7 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e tij nga emigracioni në periudhën 1991 – 1996 në shtetin grek, të cilat janë në vlerën rreth 70.000 (shtatëdhjetë mijë) euro, sipas llogaritjeve dhe konvertimeve të kryera nga

përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

subjekti. Subjekti nuk ka bashkëlidhur me deklarinimin e pasurisë asnjë dokumentacion për të provuar deklarinimin e tij.

1.8 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni⁶ gjatë hetimeve në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, shpjegon se: *“Siç e dini jam hetuar administrativisht dhe penalisht në mënyrë shteruese për pasurinë time, gjithsesi, në respekt të ligjit dhe në respektin tuaj do ju paraqes përsëri argumentet e mia. Në deklaratën Vetting kam deklaruar se gjatë punës sime si emigrant ekonomik në Greqi për periudhën 1991 – 1996 kam fituar shumën 70.000 euro. Në lidhje me këtë shumë unë nuk disponoj dokumentacion ligjor nga organet tatimore greke, pasi nuk kam qenë i pajisur me dokumentacion ligjor në shtetin grek.”*

1.9 Gjithashtu, subjekti shprehet⁷ se: *“Kam jetuar në qytetin e Athinës në lagjen ***, ku kam punuar me ditë pune në vitin e parë. Pasi jam ambientuar kam punuar në fushën e ndërtimit me normë. Të ardhurat në vit, përafërsisht, kanë qenë rreth 20.000 euro, nga të cilat kam kursyer rreth 70.000 euro, ndërsa pjesa tjetër është harxhuar për utilitete. Paratë e kursyera i kam transferuar në mënyrë periodike te prindërit në Shqipëri. Për⁸ të ardhurat gjatë kohës që kam punuar si emigrant ekonomik në Greqi jam interesuar nëpërmjet të afërmve që jetojnë dhe punojnë në shtetin grek, por nga informacionet e marra në institucionet tatimore dhe ato bankare, i kanë kthyer përgjigje se nuk janë të ruajtura pasi ka kaluar një kohë mbi 20 vjet.”*

1.10 Në përfundim, për këtë pasuri, rezulton se:

- a) është krijuar para fillimit të detyrës;
- b) subjekti nuk arrin të provojë krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga burime të ligjshme dhe të justifikuara me dokumentacion ligjor;
- c) subjekti nuk provon fitimin e të ardhurave të përdorura për të fituar këtë pasuri dhe nuk provon as transferimin e tyre në Shqipëri;
- d) subjekti ndryshon deklarinimet e veta në lidhje me datën e kryerjes së pagesës për pasurinë. Kryerja e pagesës për blerjen e saj nuk arrihet të provohet me dokumentacion, pasi është kryer *cash* përpara nënshkrimit të kontratës;
- e) subjekti nuk ka deklaruar barrën hipotekore të vendosur mbi pasurinë e tij, si dhe të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Nga marrëdhënia kontraktuale me bankën duket se vlera reale e pasurisë sot është shumë herë më e lartë se ajo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Duket se ai ka fshehur vlerën reale të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*.

1.11 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

1.12 Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se:

“Fakti që unë kam qenë në emigracion gjatë periudhës së sipërcituar është një fakt i njohur botërisht dhe i provueshëm në shumë mënyra dhe, si i tillë, duhet të merret në konsideratë në bazë të pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

Pretendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga burime të ligjshme e të justifikuara me dokumentacion ligjor, nuk qëndrojnë, duke qenë se mungesa e dokumentacionit të të ardhurave nga emigracioni nuk mund të administrohet për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe institucionet përkatëse të shtetit grek (ato tatimore dhe bankare) nuk i kanë të ruajtura për periudhën 1991 – 1996, gjatë hetimit i kam shpjeguar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se për shkak të pandemisë është e pamundur në këtë periudhë të shkoj në shtetin grek dhe të gjej punëdhënësit e mi dhe të vërtetoj të ardhurat e mia, qoftë dhe nëpërmjet një deklaratë noteriale, por Komisioni kërkon vetëm fatura bankare dhe të dhëna nga tatimet, të cilat janë të paadministrueshme dhe në bazë të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, mosparaqitja e këtyre dokumenteve është për shkaqe të arsyeshme, duke i marrë ato si të mirëqena.

Lidhur me pretendimet e Komisionit se kam ndryshuar deklarinimet në lidhje me kohën e krijimit të pasurisë mendoj se ato janë lojëra fjalësh, pa asnjë pasojë juridike mbi ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, pasi edhe po të jetë paguar vlera faktike në vitin 1997, 1998 apo 2002

kur është dokumenti zyrtar ajo pronë është blerë me të ardhurat nga emigracioni që përkojnë në kohë përpara atyre datave dhe para fillimit të detyrës.

Lidhur me provueshmërinë e transferimit të parave të fituara nga puna në emigracion në Shqipëri është absurditet të mendosh, jo më të kërkosh prova shkresore për këtë fakt duke ditur që në atë periudhë në Shqipëri s'ka pasur sistem bankar për mundësimin e transfertave nga jashtë shtetit, ekonomia ka qenë pothuajse informale dhe mendoj se mosparaqitja e këtyre dokumenteve është për shkaqe të arsyeshme të parashikuara në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me mënyrën e pagesës së vlerës për pasurinë e sipërcituar, duke pretenduar se ajo është kryer në formë cash dhe nuk provohet me dokumentacion, mendoj se pretendimi nuk qëndron, pasi edhe po të ishte kryer në rrugë bankare sistemi bankar nuk ka të dhëna për atë periudhë dhe në rastin konkret nuk mund të më bëjë mua përgjegjës për këtë fakt kur vetë Komisioni e pranon se nuk ka të dhëna të ruajtura për atë periudhë.

Lidhur me barrën hipotekore të vendosur mbi këtë pasuri mendoj se nuk kam pasur detyrim ligjor për ta bërë një gjë të tillë, pasi në rastin konkret me këtë pasuri nuk është bërë asnjë transaksion me pasojë shtimin apo pakësimin e kësaj pasurie apo përfitimin e të ardhurave nga kjo pasuri, të cilat në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, duhet të deklarohen në deklaratat periodike të pasurisë.

Lidhur me faktin se sot vlera reale e pasurisë është shumë herë më e lartë se ajo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit duke fshehur vlerën reale të kësaj pasurie në deklaratën Vetting, kam për të shpjeguar se shtimi i vlerës së pasurisë me kalimin e viteve nuk është pasuri e re, e cila duhet të deklarohet në deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë konform ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, nuk ka qenë detyrim as në plotësimin e deklaratës Vetting sipas udhëzuesit përkatës për plotësimin e kësaj deklarate.”.

1.13 Në përfundim të shpjegimeve, lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar aplikim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikës 2, të nenit 32, të po të njëjtit ligj për pamundësi objektive të njohjes së të ardhurave nga emigracioni. Lidhur me konstatimet e tjera të përcjella me rezultatet e hetimit për këtë pasuri, subjekti shpjegon se nuk ka pasur detyrimin ligjor për t'i deklaruar, në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

1.14 Për sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri dhe nuk justifikon me burime të ligjshme bërjen e saj, sipas përcaktimeve të germës “a”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

2. Pasuria tokë arë me vendndodhje në Tapizë, Tiranë, e përbërë:

A – Tokë arë me sip. 11.500 m², me nr. pasurie ***, e regjistruar në datën 27.2.2002, e blerë faktikisht në vitin 1998, e financuar nga vëllai i subjektit F. Ll. nga të ardhurat nga emigracioni në SHBA dhe Kanada. Regjistruar në emrin e subjektit për arsye se në atë kohë vëllai i tij ka qenë në njëjtën certifikatë familjare dhe nuk ka qenë në Shqipëri në momentin e regjistrimit të pasurisë. Vlera: 1.150.000 (një milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

B – Tokë arë me sip. 5.120 m², me nr. pasurie ***, e regjistruar në datën 27.2.2002, e blerë faktikisht në vitin 1998, e financuar nga vëllai i subjektit F. Ll., nga të ardhurat nga emigracioni në SHBA dhe Kanada. Regjistruar në emrin e subjektit për arsye se në atë kohë vëllai i tij ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare dhe nuk ka qenë në Shqipëri në momentin e regjistrimit të pasurisë. Vlera: 512.000 (pesëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë.

2.1 Subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën Vetting, përcjell edhe Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2017, në të cilën shtetasi F. Ll. deklaroi se në vitin 1998 ka autorizuar vëllain e tij Bardhok Lleshi që të ndërmjetësojë dhe të blejë pasurinë me nr. *** dhe pasurinë nr. *** me sipërfaqe totale 16.620 m², me çmim 100.000 (njëqind mijë) lekë/dynymi. Pagesa e kësaj vlere është bërë nga ana e tij, por regjistrimi i pasurive në emër të vëllait të tij është bërë me dakordësinë e tij për shkak të pamundësisë së tij, pasi ka qenë emigrant në SHBA si në momentin e blerjes dhe në momentin e regjistrimit të pasurive.

2.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur gjatë hetimit të Komisionit, shpjegon se këto dy pasuri janë deklaruar në DPV-në e vitit 2004 nën deklarin: “Tokë arë në Tapizë, me sip. 15.000 m². Data e krijimit: 29.1.2002, me vlerë 1.500.000 lekë. Zotëron: 0 %.” Në DPV-në e vitit 2006 subjekti deklaron se pasuria tokë arë me sip. 15.000 m², në Tapizë (deklaruar në DPV-në e vitit 2004) është blerë nga vëllai i tij, z. F. Ll..

Subjekti ka shpjeguar³ gjatë hetimit se: “Në lidhje me këtë mospërputhjen mes deklaratës Vetting dhe asaj të deklarinimit periodik vjetor përkatës, ka qenë një lapsus në deklarinim dhe nuk ka pasur asnjë qëllim për të fshehur pasurinë, pasi nga momenti i parë i deklarinimit ka dorëzuar certifikatat e pronësisë, por ngatërrimi në deklarinim është bërë se kjo pronë ka qenë e ndarë në dy certifikata pronësie.”

2.3 ASHK⁴-ja Vendore Kamëz-Vorë konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria “arë me sip. 5.120 m²”, me nr. pasurie ***, z. k. *** dhe pasuria “arë me sip. 11.520 m²”, me nr. pasurie ***, z. k. ***, të dyja pronat janë me vendndodhje në Tapizë, Tiranë. Pasuritë e mësipërme janë regjistruar në emër të subjektit në bazë të Kontratës së Shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2002, para noterit publik Xh. H.. Objekti i kontratës është shitja e dy pasurive “arë” me sip. 11.500 m² dhe sip. 5.120 m², me vendndodhje në Dritas, Tiranë, në pronësi të palës shitëse (B. T., M. T., B. T. dhe A. T.), të cilat janë fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991. Çmimi i shitjes është përcaktuar në vlerën 1.662.000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë për të dyja pronat dhe është likuiduar jashtë zyrës noteriale përpara nënshkrimit të kontratës. Bashkëlidhur kontratës gjendet dokumenti “sqarim nga noteri” në të cilën sqaron se në kontratën e shitjes është shënuar gabim çmimi i shitjes, pasi është shkruar në total. Ai vazhdon duke bërë ndarjen e çmimit të të dyja pasurive, përkatësisht: (a) pasuria nr. ***, me sip. 11.500 m² është shitur në vlerën 1.150.000 (një milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë; dhe (b) pasuria nr. ***, me sip. 5.120 m² është shitur në vlerën 512.000 (pesëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë.

2.4 Në praktikën e ASHK-së vihet re se prona me sip. 5.120 m² ka një bllokim të vendosur nga Banka Kombëtare Tregtare për shumën 7.080.000 (shtatë milionë e tetëdhjetë mijë) lekë, të vendosur nga Kontrata e Hipotekës me nr. ***, datë 27.2.2010, me noter F. K..

2.5 Komisioni i kërkoi⁵ subjektit të shpjegonte lidhur me barrën hipotekore të vendosur në favor të BKT-së, statusin aktual të pronës (nëse ka ndërtime apo investime), si dhe të pasurisë tokë arë me sip. 11.500 m², ndodhur në Tapizë, Tiranë, si dhe të përcjelljes së fotove aktuale të pasurisë.

2.6 Subjekti shpjegon se prona është vendosur për llogari të kredisë që ka marrë vëllai i tij pranë kësaj banke. Lidhur me mosdeklarinimin e këtij veprimi juridik, subjekti shpjegon se: “Nuk kam pasur detyrim ligjor për t’i deklaruar, pasi dorëzania është një marrëdhënie besimi, në rastin konkret, pa asnjë përfitim financiar apo përfitim të ndonjë natyre tjetër. Detyrimi i tij ligjor në lidhje me këto pasuri për të bërë deklarinim periodik do të ishte nëse do kishte qenë subjekti kredimarrës, nëse do të kishte kryer transaksione financiare me pronat e sipërcituara, shitblerje, dhënie me qira apo në përdorim, me qëllim nxjerrjen e fitimeve, çka në rastin konkret nuk ka ndodhur asnjëra prej tyre dhe nuk ka qenë në konflikt interesi me detyrën për këtë dorëzani. Lidhur me statusin aktual të kësaj prone, po subjekti shpjegon se ajo vazhdon të jetë me të njëjtin status ‘tokë-arë’ e lënë kolateral në Bankën Kombëtare Tregtare për llogari të kredisë, për shumën 7.080.000 (shtatë milionë e tetëdhjetë mijë) lekë. Në këtë pronë nuk ka asnjë ndërtim apo investim, bashkëngjitur subjekti përcjell fotot e pronës në statusin ‘tokë arë’.

2.7 Gjatë hetimit, subjekti u pyet⁶ nga Komisioni se përse këto prona vazhdojnë të jenë në emër të tij edhe pas 15 vjetësh nga momenti i deklaruar i blerjes (1998). Ai shpjegon: “Ju sqaroj se që nga momenti fillestar deri në deklarinimin e fundit në Vetting është shpjeguar

³ Shihni përgjigjet nr. 1 b. dhe a. pyetësor datë 7.2.2020 dhe përgjigjen 3 në pyetësor datë 9.4.2020.

⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2020, në dosjen e Komisionit.

⁵ Shihni përgjigjet nr. 4 dhe 3, pyetësori datë 13.11.2020.

⁶ Shihni përgjigjet nr. 1b. dhe a. pyetësor datë 7.2.2020.

arsyeja dhe është deklaruar se i përket 100 % vëllait tim F. Ll.. Kalimi i pronësisë është diskrecion i tij, në momentin që ai do ta kërkojë ta kalojë në emër të tij do të realizohet.”

2.8 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, i pyetur gjatë hetimit nga Komisioni⁷, subjekti shpjegon: “Vëllai F. Ll. i ka sjellë paratë e kursyera në Shqipëri nëpërmjet personave të njohur që kanë rrugëtuar në drejtim të Shqipërisë në kohë të ndryshme. Të ardhurat i ka krijuar nga puna në ndërtim, turizëm dhe shërbime. Lidhur me të ardhurat vjetore nuk jam në dijeni sa i ka pasur, ai ka dokumentacion për të ardhurat e tij, por prej disa vitesh është kthyer dhe merret me biznes në Shqipëri dhe aktualisht e ka të pamundur të rrugëtojë në drejtim të SHBA-së dhe Kanadasë për të administruar dokumentacionin përkatës për shkak të gjendjes së krijuar.”

2.9 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

- a) Pasuria është krijuar para se subjekti të ushtronte funksionin e tij si prokuror.
- b) Subjekti nuk arrin të provojë në mënyrë bindëse se pasuritë e mësipërme janë në të vërtetë në pronësi të vëllait dhe as faktin e blerjes të tyre me të ardhurat e vëllait të tij.
- c) Gjatë hetimit nuk u arrit të provohej me dokumentacion ligjor burimi i të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie sipas deklaramenteve të subjektit.
- ç) Nga hetimi i Komisionit janë ngritur dyshime se pasuritë e mësipërme: ajo e deklaruar në vitin 2004 – tokë arë në Tapizë me sip. 15.000 m², data e krijimit 29.1.2002, me vlerë 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë; si dhe pasuritë e deklaruara në Vetting – tokë arë me sip. 11.500 m² dhe tokë arë me sip. 5.120 m²; mund të jenë prona të ndryshme, pasi duket se nuk përputhet sipërfaqja e tyre (15.000 m² me 5.120 m² + 11.500 m²), si dhe vlera e çmimit të blerjes (1.500.000 lekë me 512.000 lekë + 1.150.000 lekë). Duket se subjekti ka ndryshuar deklarin në deklaratën Vetting me deklaratën e fillimit të detyrës të vitit 2004.
- d) Subjekti nuk ka deklaruar barrën hipotekore mbi këtë pasuri, si dhe detyrimet që ai ka lidhur me të, duke mosdeklaruar kështu edhe vlerën reale të kësaj pasurie në plotësimin e deklaratës Vetting.

2.10 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

2.11 Në vijim të rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasuri, subjekti, ndër të tjera, shpjegon: “Lidhur me pretendimin e Komisionit se përse dhe pas pesëmbëdhjetë vitesh prona është në emrin tim dhe nuk është transferuar në emër të vëllait tim F. Ll., duke qenë se ai është kthyer në Shqipëri prej disa kohësh, kam për të shpjeguar se ai deri në këtë moment nuk ka pasur një interes financiar me leverdi për ta shitur atë pronë, pasi po të kishte pasur një interes sigurisht do ta kishte kryer kalimin e kësaj prone, gjithsesi unë kam qenë krejtësisht i sigurt në deklarinimet e mia, pasi e kam deklaruar që në fillim se është financuar prej tij, nuk kam pasur asnjë pengesë apo problem të deklaroj si pronë timen, por duke qenë se në një moment kur ai do të vendoste për ta shitur apo për të bërë transaksione të tjera fitimprurëse me atë pronë, vlerat e transaksionit apo të mirat materiale të përfituara do të kalonin në llogaritë e tij bankare dhe, për këtë shkak, duhet të justifikohem kalimi i tyre për llogari të tij.

Gjatë hetimit kam shpjeguar se për shkak të pandemisë është e pamundur në këtë periudhë marrja e dokumentacionit për të vërtetuar të ardhurat e tij, por Komisioni ka kërkuar dhe për rastin e vëllait tim F. Ll. vetëm fatura bankare dhe të dhëna nga tatimet, të cilat janë të paadministrueshme dhe në bazë të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 mosparaqitja e këtyre dokumenteve është për shkaqe të arsyeshme, duke i marrë ato si të mirëqena. Gjatë hetimit kam paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit deklaratën noteriale të vëllait tim F. Ll. lidhur me financimin e kësaj pasurie.

Lidhur me pretendimin se pasuritë e sipërcituara nuk janë deklaruar në deklarinimet periodike vjetore, po ju shpjegoj se ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 nuk e obligon deklaruesin që një pronë të luajshme apo të paluajshme ta deklarojë çdo vit deklarues kur ajo është deklaruar një herë, ligji ka si obligim deklarinimin e ndryshimeve, pakësim, shtim, përfitime financiare apo të

⁷ Shihni përgjigjen nr. 2 të pyetësorit datë 9.4.2020.

natyrave të tjera nga marrëdhëniet kontraktuale me pronën, në rastin konkret me dy pronat e sipërcituara nuk është bërë asnjë veprim juridik me to që nga momenti fillestar i deklarimit në datën 24.3.2005.

Lidhur me pasaktësinë e sipërfaqes së përgjithshme dhe çmimit të përgjithshëm të këtyre pronësive e kam pranuar dhe gjatë hetimit se ka qenë një lapsus për shkak se prona ka qenë e ndarë në dy certifikata pronësie dhe në momentin e deklarimit fillestar nuk i kam pasur kopje të certifikatave të pronësisë për të bërë një mbledhje aritmetike, është absurditet dhe e papranueshme të mendohet se kam pasur qëllim fshehjen e pronës, po si mund të fshihet një pronë kur ajo ka një certifikatë pronësie me një numër unik me sipërfaqe të përcaktuar bashkëngjitur planin e rlevimit dhe nga kjo deklarohet 95 % e sipërfaqes dhe fshihet 5 % e saj. Unë mendoj se dhe ju jeni të bindur se unë, në këtë rast, nuk kam pasur si qëllim fshehjen apo deklarimin e rremë për këto sipërfaqe pronësie, por në mënyrë aspak pozitive dhe me tendencë gjatë raportit e keni përmendur mbi dhjetë herë si deklarim i rremë fshehje pasurie. Deklarimi im është dhe më bindës po t'i referoheni dhe kontratës së shitblerjes, ku vetë noteri ka bërë një shënim me shkrim dore se vlera e përgjithshme e shitjes së këtyre pasurive është përlllogaritur gabim. E njëjta gjë ka ndodhur dhe me sipërfaqen prej 1.200 m² në fshatin Bërxull për shkak se dhe ajo sipërfaqe pronësie ka qenë e ndarë në dy A.M.T.P., ku është deklaruar lapsus vlera e përgjithshme.

Lidhur me barrën hipotekore të vendosur mbi këtë pasuri, mendoj se nuk kam pasur detyrim ligjor për ta bërë një gjë të tillë, pasi në këtë rast, me këtë pasuri, nuk është bërë asnjë transaksion me pasojë shtimin e pakësimin e kësaj pasurie apo përfitimin e të ardhurave nga kjo pasuri, të cilat në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, duhet të deklarohen në deklaratat periodike të pasurisë.

Lidhur me faktin se sot vlera reale e pasurisë është shumë herë më e lartë se ajo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, duke fshehur vlerën reale të kësaj pasurie në deklaratën Vetting, kam për të shpjeguar se shtimi i vlerës së pasurisë me kalimin e viteve nuk është pasuri e re, e cila duhet të deklarohet në deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë konform ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, nuk ka qenë detyrim as në plotësimin e deklaratës Vetting sipas udhëzuesit përkatës për plotësimin e kësaj deklarate.”

2.12 Shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk e bindën trupin gjykues lidhur me të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në përfundim të vlerësimit, për këtë pasuri, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se pasuria tokë arë me sip. 11.500 m², me nr. pasurie ***, e regjistruar në datën 27.2.2002 dhe tokë arë me sip. 5.120 m², me nr. pasurie ***, e regjistruar që në datën 27.2.2002, në emër të subjektit të rivlerësimit, nuk provohet në ndonjë mënyrë ligjore se ajo nuk është pasuri e subjektit të rivlerësimit, e se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germave “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84.2016, ku subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë për këtë pasuri dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj.

3. Pasuria apartament me sip. 124.1 m², me nr. pasurie *,** ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, i porositur në vitin 2003 dhe regjistruar sipas Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2012, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. Vlera e blerjes është 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) euro, konvertuar në lekë në shumën 8.034.000 (tetë milionë e tridhjetë e katë mijë) lekë në momentin e përpilimit të kontratës së shitblerjes. Pjesa takuese: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten.

3.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim për pasurinë e mësipërme: “... pagesa është bërë me këste, ku në momentin e porosisë, në vitin 2003, janë paguar 25,000 euro, ndërsa pjesa tjetër është paguar me kredi.”

3.2 Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se kjo pasuri nuk është deklaruar në deklarimin fillestar të vitit 2004 dhe as në DPV-në e vitit 2005. Në DPV-në e vitit 2005, subjekti deklaroi kredi bankare për blerje apartamenti në vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro dhe kredi bankare për mobilim në vlerën 20.000 (njëzet mijë) euro.

3.3 Në DPV-në e vitit 2006, subjekti deklaroi: “Shtëpi banimi me sip. 135 m² në rrugën ‘***’, me Kontratë Sipërmarrjeje në vitin 2003, nga e cila kam paguar 25,000 euro në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa, në vitin 2004 nuk kam paguar detyrim ndaj firmës. Vlera e apartamentit është 60,000 euro dhe detyrimi ndaj firmës është 35,000 euro. Datë krijimi e pasurisë deklaroi vitin 2003. Zotëron 100 %”.

3.4 Në DPV-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi blerjen finale dhe regjistrimin në hipotekë të pasurisë apartament me sip. 124.1 m², sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2012, të lidhur me shoqërinë ‘****’ sh.p.k. Vlera totale e pasurisë në këtë kontratë është 8.034.000 (tetë milionë e tridhjetë e katër mijë) lekë.

3.5 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “... shlyer detyrimi prej 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro për llogari të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., diferencë e mbetur për blerjen e apartamentit në njësinë administrative nr. ***, Blv. ‘****’”.

3.6 ASHK-ja⁸ Vendore Tirana Jug konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij figurojnë e regjistruar pasuria me nr. ***, e ndodhur në Rr. ‘****’, Tiranë, regjistruar sipas Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2012, me palë shitëse shoqërinë ‘****’ sh.p.k., në vlerën 8.034.000 (tetë milionë e tridhjetë e katër mijë) lekë, të shlyera tërësisht shoqërisë.

3.7 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, gjatë pyetësorëve të Komisionit subjekti ka deklaruar se pasuria është krijuar në momentin e porosisë në vitin 2003, ku është paguar shuma 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, ndërsa pjesa tjetër është paguar me kredi. Pagesa e parë prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro është realizuar me të ardhurat nga emigracioni; pagesa e dytë prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro është shlyer me kredi bankare.

3.8 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni⁹, shpjegon se nuk i kujtohen me data konkrete, rëndësi ka që ia ka shlyer detyrimin shoqërisë ‘Sinani’ sh.p.k. nëpërmjet kësaj kredie dhe me atë kredi nuk ka krijuar pasuri tjetër të luajtshme apo të paluajtshme, gjithçka tjetër është hamendësim.

3.9 Lidhur me kredinë e marrë nga “Emporiki Bank” sh.a., subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting, në seksionin e detyrimeve financiare: (a) kredi për blerje apartamenti¹⁰ në adresën: Njësia Administrative Nr. ***, Blv. ‘****’, nd. ***, h. ***, ap. ***, Bashkia Tiranë, në shumën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, sipas Kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.2005, të lidhur me “Emporiki Bank” sh.a.; (b) kredi për mobilim¹¹ apartamenti në adresën: Njësia Administrative Nr. ***, Blv. ‘****’, nd. ***, h. ***, ap. ***, Bashkia Tiranë, në shumën prej 20.000 (njëzet mijë) euro, sipas Kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.2005, të lidhur me “Emporiki Bank” sh.a.; (c) garanci hipotekore për të dyja këto hua është lënë pasuria “arë me sip. 1.200 m²”; (ç) kjo hua është shlyer në datën 15.12.2010.

3.10 Nga hetimi i llogarive bankare pranë “Emporiki¹² Bank” rezultoi se të dyja huat janë lëvruar në datën 15.12.2005 dhe janë tërhequr cash nga subjekti në datat dhe vlerat e mëposhtme:

Data e tërheqjes	Shuma e tërhequr
27.12.2005	15,000 euro
16.8.2006	10,000 euro
12.9.2006	5,000 euro
12.10.2006	5,000 euro
26.10.2006	10,900 euro
Totali	45,900 euro

⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020, në dosjen e Komisionit.

⁹ Shihni përgjigjen nr. 9 të pyetësorit datë 9.4.2020.

¹⁰ Shihni dosjen ILDKPKI, Aneks ***.

¹¹ Shihni dosjen ILDKPKI, Aneks ***.

¹² Shihni vërtetimin nga “ABI Bank” datë 5.1.2017, nr. ref. ***, dosja ILDKPKI, Aneks *** dhe Aneks *** me vërtetimin “Emporiki Bank” sh.a., datë 18.5.2012, nr. ***.

3.11 Nga hetimi i llogarive bankare të subjektit rezultoi se janë bërë derdhje të herëpashershme në llogarinë e tij nga persona të tretë, të cilat sipas përshkrimit duket se kanë pasur qëllim pagesën e detyrimeve të kredive. Këto derdhje janë kryer nga shtetasit S. M. (vëllai), N. Ll. (vëllai), N. M. (kunati) dhe P. M. (motra e subjektit) – ato kanë filluar prej vitit 2006 dhe gjatë gjithë periudhës në vazhdim.

3.12 Gjatë hetimeve të Komisionit¹³ subjekti ka shpjeguar se: *“Të ardhurat për shlyerjen e kredisë nga viti 2006 deri në vitin 2009 kanë si burim të ligjshëm të ardhurat që kam deklaruar nga paga ime dhe e bashkëshortes dhe nga bar-kafe ***. Të ardhurat e saj i kam administruar unë sipas një prokure të posaçme (të vitit 2004) që kam pasur nga vëllai im F. Ll.. Pagesa e kësteve është bërë nga familjarët e mi, të cilët kanë menaxhuar punën në këtë lokal, përkatësisht N. Ll. (vëllai), N. M. (kunati) dhe P. M. (motra e subjektit). Ndërsa pas vitit 2010, ku vëllai im F. Ll. është larguar nga certifikata familjare, pagesa e kredisë është marrë përsipër nga shoqëria ‘****’ sh.p.k., sipas një kontrate të lidhur midis meje dhe kësaj shoqërie në datën 26.7.2010, e cila ka kryer të gjitha pagesat që nga ai moment e në vazhdim.”*

3.12.1 Subjekti përcjell Kontratën e Sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., lidhur me shoqërinë ‘****’ sh.p.k., në datën 26.7.2010, me objekt ndërtimin mbi sipërfaqen e tokës 1.200 m², në pronësi të shtetasit Bardhok Lleshi. Në këtë kontratë përcaktohet se me përfundimin e dorëzimit të objektit, pronarit të tokës (subjektit) i hiqet e drejta e pronësisë mbi truallin, ndërsa shoqëria në kompensim të vlerës së tokës merr përsipër të likuidojë tërësisht huan e mbetur të palikuiduar nga shtetasi Bardhok Lleshi (pronari) në “Emporiki Bank” sh.a.

3.13 Lidhur me këtë pasuri konstatohet se:

- a) Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij dhe mundësitë financiare për pagesën e këstit të parë në shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro.
- b) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* se kredia bankare ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti nuk përputhen me deklaratimet periodike vjetore të vitit 2006. Gjatë hetimit nuk është provuar në ndonjë mënyrë se pagesat e kryera për këtë pasuri në vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, janë kryer nëpërmjet vlerave të siguruara nga kredia bankare.
- c) Mbeten të paprovuara me dokumentacion ligjor, burimi i të ardhurave, lidhur me pagesat e kryera nga të tretët për llogari të kredisë në emër të subjektit të rivlerësimit, marrë në “Emporiki Bank” sh.a.
- ç) Vlera prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro nuk është përfshirë si shpenzim, në analizën financiare të Komisionit për vitet 2003 – 2016, pasi nuk ka qenë e mundur të identifikohet koha në të cilën ai shpenzim është realizuar. Vlera e kredisë është përfshirë si e ardhur, njëkohësisht edhe shlyerja e saj sipas dokumenteve bankare, duke mos përfshirë shpenzime shtesë në vlerën prej 20.000 (njëzet mijë) euro për arredimin e apartamentit, të deklarura nga subjekti i rivlerësimit.

3.14 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

3.15 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon:

“Në lidhje me mosdeklarimin e apartamentit të banimit në deklaratën fillestare po ju shpjegoj përsëri se në formularin e deklarimit fillestar nuk ka pasur asnjë rubrikë për deklarimin e kontratave të sipërmarrjes, ajo është një kontratë premtimi e cila presupozohet se do të realizohet në të ardhmen e cila mund dhe të mos ndodhë. Në asnjë nen të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, kontrata e sipërmarrjes nuk bën pjesë të pasuritë e luajtshme, të paluajtshme, llogari bankare korrente apo me afat, bono thesari dhe emtime të ngjashme, për të cilin subjekti në bazë të këtij ligji duhet të deklarojë si pasuri kontratën e sipërmarrjes, sigurisht duke qenë fillimi i implementimit të ligjit institucioni përgjegjës dhe subjektet deklaruese nuk kanë pasur

¹³ Shihni përgjigjen nr. 4, të pyetësorit datë 9.4.2020.

informacionin e duhur, pra kjo është arsyeja që nuk është deklaruar asnjëherë, nuk kam pasur si qëllim të fsheh asgjë rreth apartamentit të banimit të prenotuar në vitin 2003. Lidhur me deklarin e kontratës së sipërmarrjes ka pasur një precedent ligjor në Republikën e Shqipërisë dhe praktika gjyqësore i ka dhënë zgjidhje këtij konflikti duke mos e konsideruar si detyrim ligjor për t'u deklaruar në deklarinet periodike, por i detyruar është deklarimi i produktit që ajo prodhon nëse realizohet.

Lidhur me deklarin për vlerën e mbetur të detyrimit ndaj shoqërisë '***' sh.p.k., në DPV-në e vitit 2006 prej 35,000 euro, sqaroj se: në deklaratën periodike të vitit 2006 kam deklaruar detyrimin i cili ka qenë me datë 31.12.2005, pasi në çdo vit deklarues deklarohen të gjitha pasuritë dhe detyrimet që subjekti ka pasur në përfundim të vitit paraardhës dhe jo të vitit korrent.

Lidhur me pagesën prej 2.500 euro e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015 pas kalimit të pronësisë unë kam qenë korrekt në deklarinim tim pasi ajo vlerë është paguar për një diskutim që ka lindur me z. S. për pjesët e përbashkëta, pasi siç e keni konstatuar dhe ju gjatë hetimit kontrata e sipërmarrjes është lidhur për një sipërfaqe prej 133 apo 135 m², nëse jam i saktë dhe në kontratë e shitjes sipërfaqja e apartamentit është 124.1 m², pasi pjesët e përbashkëta nuk regjistrohen si pjesë e pasurisë individuale, pagesa është bërë cash dhe të ardhurat kanë qenë mëse të dokumentuara.

Lidhur me pretendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se pagesat janë bërë cash dhe nuk dokumentohet se kredia është përdorur për blerjen e apartamentit, kam për të shpjeguar se pas fillimit të detyrës është e vetmja pronë e financuar pjesërisht prej meje gjatë kësaj periudhe nuk kam blerë ndonjë pronë tjetër dhe nuk kam shlyer ndonjë detyrim tjetër. Fakti i përdorimit të kredisë për blerjen e apartamentit dhe mobilimin e tij është provuar dhe nga deklarinet e dhëna nga z. F. S.. Në kohën kur janë kryer veprimet financiare për blerjen e apartamentit nuk ka qenë e detyrueshme kalimi i vlerave në rrugë bankare, ka qenë kërkesa e z. S. që t'ia japë cash, kjo ka qenë arsyeja sigurisht e pamenduar se një ditë do të ishim përpara këtij Komisioni, sepse nuk do kishte ndodhur mundësia për të parashikuar se çfarë ligji do të miratohej pas pesëmbëdhjetë viteve për këtë lloj marrëdhënie juridiko-civile kanë qenë zero.

Pagesa e kryer ndaj z. S. për apartamentin e banimit është provuar gjatë hetimit administrativ dhe penal, akte të cilat ju i keni administruar gjatë procesit, hamendësimet e Komisionit nuk janë fakte dhe nuk kanë lidhje me mua, nëse ju mendoni se z. S. ma ka dhënë pa lekë apartamentin ai është problemi juaj.

Pika 2, e nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 e ka të shprehur qartë se deklarinet e dhëna nga dëshmitari ose eksperti gjatë një procesi penal mund të përdoren me cilësinë e provës, besoj e keni provën se kam kryer të gjitha pagesat ndaj shoqërisë '***' për blerjen e apartamentit.

Lidhur me pagesën e kredisë nga persona të tretë, subjekti shpjegon se pagesat e kryera janë nëpërmjet bankës me të ardhurat e mia, të bashkëshortes, të bar-kafe '***'.

Lidhur me pagesat e kredisë të kryera nga vëllai Simon Marku nga viti 2010 deri në mbylljen e kredisë duke kërkuar të provojë mundësitë financiare të tij, po ju shpjegoj se të gjitha detyrimet e kredisë së marrë pranë 'Emporki Bank', e cila ndër vite ka ndërruar disa herë pronar janë kryer prej tij nga të ardhurat e tij nga aktiviteti tregtar, gjë e cila dokumentohet nga depozitimi i bilanceve të tij nga viti 2010 e në vazhdim."

3.16 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësitë e tij financiare për pagimin e vlerës prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro në vitin 2003 dhe ligjshmërinë e burimit të tyre.

Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë trupin gjykues se fondet e kredisë së marrë prej tij në "Emporiki Bank" sh.a., në vitin 2005 kanë shërbyer për kryerjen e pagesave për vlerën e mbetur të apartamentit. Deklarinet e tij nuk përputhen me rezultatet e hetimit të Komisionit.

Në vijim të shpjegimeve të subjektit rezulton se nga bilancet e përcjella të shoqërisë tregtare '***' sh.p.k. duket se ata nuk kanë shpërndarë dividend, si dhe nuk rezultojnë përshkrime

shpenzimesh apo pagesa për detyrime në pasqyrat financiare të shoqërisë, lidhur me shlyerjen e detyrimit të kredisë për llogari të z. Bardhok Lleshi.

3.17 Shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk e bindën trupin gjykues lidhur me të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në përfundim të vlerësimit për këtë pasuri, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar kryerjen e pagesave për blerjen e kësaj pasurie si dhe burimin e ligjshëm të tyre. Subjekti nuk ka provuar se kredia bankare në “Emporiki Bank” sh.a., ka shërbyer për blerjen pasurisë apartament me sip. 124.1 m², në Tiranë dhe se pagesat e kryera për likuidimin e kredisë nga persona të ndryshëm (të afërt t tij) mbeten me burime të panjohura e të paprovuara.

Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe se ai ndodhet në kushtet e germave “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Pasuria bodrum me sip. 600 m², nr. pasurie ***, regjistruar në datën 6.6.2015, me Kontratën e Shkëmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.6.2015. Pjesa takuese: 100 %.

4.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim për pasurinë e mësipërme: “... nga Kontrata e Shkëmbimit me nr. ***, datë 5.6.2015.”.

4.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 është deklaruar pakësimi i pasurisë me anë të Kontratës së Shkëmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.6.2015, duke u tjetërsuar dhe këmbyer me pasurinë tokë arë, me sip. 1.200 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në Bërxull.

4.3 Subjekti përcjell në deklaratën *Vetting* Kontratë Shkëmbimi¹⁴ të pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.6.2015, para noterit publik E. H., me palë shtetasit S. M. dhe Bardhok Lleshi. Në këtë kontratë përshkruhet se pasuria arë me sip. 1.200 m² e ndodhur në Bërxull, Tiranë, me nr. pasurie ***, z. k. ***, shkëmbehet me pasurinë bodrum me sip. 600 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***. Në kontratë përcaktohet se subjekti ka nënshkruar me shoqërinë “***” sh.p.k. Kontratë Sipërmarrjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2010 dhe se mbi pasurinë arë me sip. 1.200 m² ka barrë hipotekore në favor të “Emporiki Bank” sh.a., të vendosur me Kontratë Hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.2005. Banka ka dhënë miratimin me Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2010, për ndërtimin e një objekti mbi pasurinë e sipërcituar sipas Lejes së Ndërtimit nr. ***, datë 27.7.2010, të KRRT-së Bërxull.

4.4 Në Kontratën e Sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2010, të nënshkruar midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe subjektit Bardhok Lleshi përshkruhet se me përfundimin dhe dorëzimin e objektit, pronarit të tokës i hiqet e drejta e pronësisë mbi truallin, ndërsa shoqëria ndërtuese detyrohet që të shlyejë në këmbim të vlerës së tokës vetëm shumën e huas që pala pronare e tokës ka ndaj “Emporiki Bank”, duke mos cituar ndonjë sipërfaqe ndërtimi për t’u shkëmbyer në këtë objekt.

4.5 Subjekti, i pyetur¹⁵ nga Komisioni, ka shpjeguar se nuk ishte i kënaqur vetëm me pagesën e kredisë dhe shoqërisë i kërkoi që për tokën e vënë në dispozicion të përfitojë edhe sip. 600 m², të cilën shoqëria e pranoi.

4.6 ASHK¹⁶-ja Vendore Kamëz-Vorë konfirmon në emër të subjektit të rivlerësimit pasurinë bodrum me sip. 600 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, fituar nëpërmjet Kontratës së Shkëmbimit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.6.2015, në këmbim me pasurinë arë me sip. 1.200 m², ndodhur në Bërxull, Tiranë.

4.7 ASHK-ja¹⁷ ka përcjellë për pasurinë “arë me sip. 1.200 m²” të dhënat: Certifikatën e Pasurisë me nr. ***, z. k. ***, me pronar z. Bardhok Lleshi, burimi i pasurisë janë dy Kontrata Shitjeje të tokave bujqësore me nr. *** rep., nr. *** kol., të nënshkruara në datën 6.7.1998, me

¹⁴ Shihni dosjen ILDKPKI Aneks ***.

¹⁵ Shihni përgjigjen nr. 5 të pyetësorit datë 9.4.2020.

¹⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020, në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020, në dosjen e Komisionit dhe në dosjen e ILDKPKI-së Aneks ***.

palë shitëse shtetasit D., S., M. dhe B. H. dhe kontrata e dytë me referencë nr. *** rep., nr. *** kol., me palë shitëse shtetasit M., H., J. dhe Xh. H. dhe palë blerëse shtetasin Bardhok Lleshi. Pronat e përshkruara në këto kontrata kanë sip. 600 m²/secila dhe çmimet e shitjes së tyre janë përcaktuar në vlerën 850.000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë secila, të cilat janë likuiduar përpara noterit. Pas nënshkrimit të Kontratës së Shkëmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.6.2015, pronësia e pasurisë arë me sip. 1.200 m² ka kaluar te shtetasi S. M. (vëllai i subjektit). Gjithashtu janë përcjellë edhe dokumentet e ndërtimit të shoqërisë “****” sh.p.k., ku Leja e Ndërtimit nr. ***, datë 27.7.2010, rezulton për ndërtim godinë shërbimesh 3k+1k bodrum, vendimi nr. ***, datë 15.6.2010, i KRRT-së, përshkruan sipërfaqen e sheshit të ndërtimit prej 1/200 m².

4.8 Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri rezulton se deklaratimet e tij nuk përputhen me të dhënat e ardhura nga ASHK-ja. Vlera prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2004, për krijimin e kësaj pasurie, është e ndryshme me vlerën që rezulton nga kontratat e shitjes të përcjella në Komision, e cila pasqyron vlerën totale prej 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekësh. Data e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklarimin fillestar të vitit 2004 “si data e krijimit 17.8.1998” është e ndryshme me datën e evidentuar në kontratat e shitjes, 6.7.1998.

4.9 Në shpjegimet e tij, subjekti e ka referuar këtë mospërputhje si pasaktësi, e cila ka ndodhur në momentin e deklarimit fillestar, pasi ai nuk ka arritur të gjejë kopje të akteve noteriale të blerjes. Subjekti shpjegon se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga emigracioni në vitet 1991 – 1996, për të cilat nuk ka dokumentacion provues.

4.10 Gjatë hetimit ka rezultuar pasuria arë me sip. 1.200 m², e cila ka shërbyer si garanci për një hua që subjekti i rivlerësimit ka marrë në vlerën prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro me afat shlyerje 2 vjet. Kontrata e Huas¹⁸ datë 28.4.2005 është lidhur me shtetasin L. N. (huadhënës).

4.11 Ky fakt nuk rezulton i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet e tij periodike vjetore përkatëse.

4.12 Subjekti i rivlerësimit, pasi është pyetur nga Komisioni¹⁹, shpjegon se shtetasi L. N. ka pasur si qëllim të blinte pronën dhe kontrata është përpiluar për t’u siguruar se nuk do ta blinte ndonjë person tjetër për një periudhë kohe prej një muaji, kohë gjatë së cilës ai do të siguronte shumën e parave. Duke qenë se ai nuk e siguroi dot vlerën e sipërcituar, ka hequr dorë nga blerja dhe në datën 27.5.2005 të dy palët kanë përpiluar një deklaratë me shkrim për anulimin e kësaj kontrate. Në kontratë është përcaktuar se huadhënësi do të bënte bllokimin e pronës pranë ZRPP-së Tiranë, por nuk është bllokuar prej tij pasi ai ka hequr dorë.

Subjekti ka përcjellë dokumentin “deklarata jonoteriale” e firmosur nga shtetasit L. N. dhe Bardhok Lleshi në datën 27.5.2005, në të cilën të dyja palët deklarojnë se është anuluar Kontrata e Huamarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.4.2005, sepse pala huadhënëse (L. N.) tërhiqet.

4.13 Në lidhje me vlerën e pasurisë së përfituar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni mori si referencë vlerat e EKB²⁰-së në vitin 2015, nga të cilat rezultoi se çmimi i shitjes për sipërfaqe të shfrytëzueshme është 51.500 lekë/m². Në bazë të saj, kostoja totale e pasurisë që përfiton subjekti është²¹ në vlerën mesatare prej 30.900.000 (tridhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekë²², si dhe vlerën e mbetur të huas.

¹⁸ Shihni Aneks ***, dosja ILDKPKI, Kontratën e Huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.4.2005.

¹⁹ Shihni përgjigjen nr. 5, të pyetësorit datë 13.11.2020.

²⁰ Shihni udhëzimin nr. 4, datë 30.9.2015.

²¹ Llogaritur 600 m² x 51.500 lekë/m².

²² Konvertuar vlera e blerjes 60.000 euro me kursin mesatar të BOA-s për vitin 2003.

https://ëëë.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_këmbimit/Arkiva_e_kursit_të_këmbimit/

4.14 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka përcjellë, lidhur me pasurinë “arë me sip. 1.200 m²”, disa kontrata qiraje²³ të lidhura me subjekte të ndryshme për dhënien me qira të saj dhe krijimin e të ardhurave.

4.14.1 Kontratë Qiraje me nr. *** rep., nr. *** kol., e lidhur në datën 13.11.2009, para noterit publik Xh. H. me shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi I. D. (përfaqësuar me prokurë B. D.). Shuma e qirasë mujore është 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë, e cila është përcaktuar se do të paguhet *cash* dhe gjithashtu në kontratë është përcaktuar se detyrimet ndaj shtetit, sipas ligjit, do të paguhet nga qiradhënësi. Në pikën 2, të nenit 3, në kontratë, parashikohet se pas përfundimit të qirasë 1-vjeçare, pasuria do të kalojë në pronësi të qiramarrësit “****” sh.p.k., sipas një akti të mëvonshëm noterial.

4.14.1.1 Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 të ardhura nga kjo kontratë qiraje në vlerën 720.000 (shtatëqind e njëzet mijë) lekë dhe në deklaratën *Vetting* deklaroi të ardhura nga kjo kontratë qiraje në vlerën 960.000 (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

4.14.1.2 Subjekti, në përgjigjet e pyetësorëve, ka shpjeguar për Komisionin se kontrata e qirasë me shoqërinë “****” sh.p.k. është bërë me qëllim blerjen e pronës dhe shoqëria e ka mbajtur me qira, për sa kohë është përpjekur të sigurojë vlerën për blerjen e saj, në momentin që qiramarrësi nuk ka mundur të sigurojë vlerën është larguar në mënyrë të njëanshme. Lidhur me pagesën e tatim-fitimit për këtë kontratë dhe për kontratat e tjera subjekti deklaroi se ai gjithmonë ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe nuk ka asnjë koment për kontratat ligjore të bëra para noterit publik.

4.14.1.3 Gjatë korrespondencës së kryer nga Komisioni me organet tatimore²⁴ nuk rezultuan të dhëna për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja për këto kontrata dhe, për pasojë, nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.

4.14.2 Kontratë Qiraje me nr. *** rep., nr. *** kol., e lidhur në datën 30.4.2011, para noterit publik Xh. H., palë qiramarrëse shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi R. B. H.. Objekti i kontratës është dhënia me qira e pasurisë “arë me sip. 1.200 m²” me afat 1-vjeçar, me qira mujore 600 (gjashtëqind) euro, plus tatimin në burim 60 (gjashtëdhjetë) euro dhe për të cilën është përcaktuar në kontratë se do të paguhet nga qiramarrësi.

4.14.2.1 Nga hetimi rezulton se kontrata është lidhur ndërkohë që subjekti i rivlerësimit kishte lidhur Kontratën e Sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2010, me shoqërinë “****” sh.p.k., të përshkruar më lart në këtë vendim.

4.14.2.2 Kontratë Qiraje me nr. *** rep., nr. *** kol., e lidhur në datën 19.11.2012, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., në të cilën përcaktohet afati i zgjatur pas përfundimit të kontratës së mësipërme (datë 1.8.2012) deri më 1.8.2014. Në këtë kontratë amendohet edhe vlera e qirasë në 1.000 euro/muaj, pa përfshirë tatimin në burim, i cili përcaktohet në kontratë se do të paguhet nga qiramarrësi.

4.14.2.3 Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni me organet tatimore²⁵ nuk rezultuan të dhëna për regjistrimin e këtyre kontratave pranë organeve tatimore, si dhe pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja për to dhe, për pasojë, të ardhurat nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.

4.14.2.4 Duket se këto dy kontrata janë pa një logjikë tregtare dhe ekonomike për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka lidhur Kontratën e Sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2010, me shoqërinë “****” sh.p.k., duket se ato janë kontrata fiktive.

4.14.3 Kontratë Qiraje me nr. *** rep., nr. *** kol., e lidhur në datën 27.9.2014, para noterit publik Xh. H., me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi L. N.. Objekti i kontratës është dhënia me qira e pasurisë “arë me sip. 1.200 m²”, me qira mujore 1.000 (një

²³ Shihni dosjen ILDKPKI Aneks ***.

²⁴ Shihni dosjen ILDKPKI Aneks ***, komunikimet elektronike dhe nga shkresa e DTR-së në dosjen e Komisionit nr. ***, datë 17.2.2020.

²⁵ Shihni dosjen ILDKPKI, Aneks ***, komunikimet elektronike dhe nga shkresa e DTR-së në dosjen e Komisionit me nr. *** prot., datë 17.2.2020.

mijë) euro plus tatimin në burim 100 (njëqind) euro, për të cilën është përcaktuar në kontratë se do të paguhet nga qiramarrësi. Afati i kontratës është nga data 1.8.2014 deri më 31.12.2018.

4.14.3.1 Kontratë Qiraje me nr. *** rep., nr. *** kol., e lidhur në datën 5.3.2016, para noterit publik E. H., në të cilën deklarohet se pas nënshkrimit të Kontratës së Shkëmbimit nr. ***, datë 5.6.2015, ku subjekti ka përfituar pasurinë “bodrum me sip. 600 m²” – shoqëria “****” sh.p.k. do të vazhdojë të mbajë me qira pasurinë e përfituar “bodrum me sip. 600 m²”, me qira mujore 1.000 euro/muaj, por tatimi në burim do të merret përsipër nga qiradhënësi. Afati mbetet i njëjtë, deri më 31.12.2018.

4.14.3.2 Nga vlerësimi i dokumentacionit rezulton se amendimi i kontratës së qirasë është nënshkruar 9 muaj pas nënshkrimit të kontratës së shkëmbimit të pasurisë, ndërkohë që subjekti ka vazhduar të marrë përfitimet nëpërmjet të ardhurave nga qiraja mbi një pronë, e cila nuk ishte më e tija prej 9 muajsh.

4.14.3.3 Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni me organet tatimore²⁶ nuk rezultuan të dhëna për regjistrimin e këtyre kontratave pranë organeve tatimore. DRT-ja Lezhë konfirmon se nuk janë deklaruar dhe as nuk janë shlyer detyrimet tatimore për kontratat e mësipërme të lidhura me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe, për pasojë, të ardhurat nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.

4.15 Nga hetimi ka rezultuar se pagesat për të ardhurat nga qiraja, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për kontratat e mësipërme, janë të gjitha të kryera me pagesa *cash*, megjithëse subjektet qiramarrëse ishin persona juridikë që qarkullonin të ardhurat/shpenzimet e shoqërisë nëpërmjet llogarive bankare. Po ashtu, nga informacionet e mbledhura nga organet tatimore nuk rezultuan të dhëna lidhur me pagimin e tatimit përkatës apo deklarimin e këtyre kontratave të qirasë nga subjektet qiramarrëse apo nga qiradhënësi. Subjekti i rivlerësimit, po ashtu, nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues lidhur me pagimin e tatimit mbi të ardhurat e deklaruara si të përfituara prej tij nga qiratë.

4.16 Komisioni ka hetuar lidhur me konfliktet e mundshme të interesit të subjektit të rivlerësimit. Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka rezultuar se prokurori Bardhok Lleshi ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2013, me kallëzues shtetasin L. N., me cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., duke bashkëlidhur vendimin për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013.

4.17 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasuri.

4.18 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “... lidhja e kontratës me shtetasin L. N. në vitin 2005 ka pasur si qëllim blerjen e sipërfaqes së pronësisë prej 1.200 metër nga ai dhe për këtë fakt në kontratë është cituar edhe bllokimi i kësaj prone në ZVRPP-në Tiranë, me qëllim që gjatë një periudhe prej disa muajsh kjo pronë të mos shitej. Qëllimi i shitjes së pronës ka qenë pagimi i pjesës së mbetur të detyrimit që unë kisha për apartamentin e prenotuar te shoqëria ‘***’ sh.p.k., dhe kur shitja e saj nuk është realizuar unë kam ndërmarrë hapat e tjerë për të marrë kredi, gjë të cilën e kam realizuar në fundin e vitit 2005. Z. L. N. në datën 27.5.2005 është tërhequr nga kjo marrëdhënie me anë të një deklaratë të nënshkruar nga të dyja palët kontraktore.

Përfundimisht, Kontrata e Huas prej 150.000 euro, e lidhur me shtetasin L. N. në datën 28.4.2005, nuk është ekzekutuar në asnjë moment dhe, si e tillë, ajo nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike, gjë e cila vërtetohet nga deklaratat e palëve kontraktore që mban datën 27.5.2005, ku palët kanë hequr dorë nga ajo kontratë e lidhur. Vetë Komisioni, gjatë hetimit e ka vërtetuar se unë nuk kam kryer asnjë veprim juridik që ka të bëjë me transaksione prone, bankare apo të çfarëdolloji qoftë që të ketë një vlerë që përkon me shumën 150.000 euro në kohën e lidhjes së kësaj kontrate huaje apo më vonë.”

²⁶ Shihni dosjen ILDKPKI, Aneks ***, komunikimet elektronike dhe nga shkresa e DTR-së në dosjen e Komisionit me nr. *** prot., datë 17.2.2020.

4.18.1 Lidhur me konfliktin e interesit me shtetasin L. N. subjekti shpjegon: “... kjo është e pambështetur pasi në vitin 2013 unë nuk kam pasur asnjë marrëdhënie kontraktuale me këtë shtetas, shtu këtu faktin se në rastin në fjalë ka qenë i dëmtuar për një kundërvajtje penale që ndiqet me ankim dhe referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 dhe parashikimeve ligjore të neneve 15,16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale nuk rezulton të kem ushtruar detyrën në konflikt të interesit apo në kundërshtim me ligjin.

Lidhur me përputhjen e interesave të shoqërisë në këtë marrëdhënie kontraktuale dhe trajtim preferencial mbi përfitimet e mia në këtë pronë, mendoj se është një mendim i Komisionit i pabazuar në prova konkrete, pasi interesat e shoqërisë në një marrëdhënie kontraktuale i përcakton vetë shoqëria dhe askush tjetër, e rëndësishme është se marrëdhënia juridike me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. nuk është në konflikt interesi.

Komisioni ka ngritur në mënyrë të padrejtë në lidhje me kontratën e këmbimit sipërfaqen prej 600 m² (bodrum), duke pretenduar se kam fshehur vlerën reale të pasurisë, gjë e cila është jo vetëm e pavërtetë, pasi nuk jam unë ai që përcaktoj indeksin e rritjes së çmimeve të pronës me kalimin e kohës. Sipas tyre, një gjë të tillë duhet ta kisha deklaruar në formularin Vetting, por ai formular dhe udhëzuesi i plotësimit të tij nuk ka pasur një referencë të tillë apo një obligim ligjor, pasi vlerën reale të çdo prone e përcakton oferta e tregut.

...

Kam për të shpjeguar se kontratat janë lidhur konform parashikimeve ligjore përkatëse, kam respektuar ligjin duke i deklaruar gjatë deklarimeve, kam paguar detyrimet tatimore kur ato kanë qenë në ngarkimin tim, nuk është përgjegjësi e imja fakti se tatimet nuk kanë të dhëna dhe dokumentacion përkatës, ky nuk është një fakt i ri, është i njohur pasi disa organe shtetërore, përfshi dhe tatimet apo bankat dhe institucionet e tjera ku bëhen pagesa nuk i ruajnë ato pasi të ketë kaluar afati 5-vjeçar. Në rastet kur detyrimin e ka pasur qiramarrësi është e zgjidhur në kontratë dhe nuk kam asnjë përgjegjësi për mosrespektimin e një detyrimi tatimor nga pala kontraktuale, e cila e ka marrë përsipër me vullnet të plotë pagimin e detyrimit tatimor në burim.”.

4.19 Shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk e bindën trupin gjykues lidhur me të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në përfundim të vlerësimit për këtë pasuri trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare nga të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë tokë arë me sip. 1.200 m², ndodhur në Bërxullë, e të shkëmbyer fillimisht me vlerën e mbetur të kredisë në “Emporiki Bank”, shtuar më vonë edhe me pasurinë bodrum me sip. 600 m².

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me veprimet e mëvonshme e të njëpasnjëshme me këtë pasuri, si kontratat e huadhënies dhe ato të qirave, si dhe të ardhurat e përfituara prej tyre nuk janë deklaruar të plota. Nuk rezultoi e provuar me dokumentacion se kontratat e qirave kanë qenë të deklaruara/regjistruara pranë organeve tatimore dhe se për të ardhurat e deklaruara të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse, duke kënaqur kështu kërkesat e nenit D, paragrafi i tretë, i Aneksit të Kushtetutës. Kontrata e Huas në vitin 2005 me shtetasin L. N. e lidhur para noterit publik por e ndryshuar me deklaratë të thjeshtë, nuk e bindi trupin gjykues për vërtetësinë e saj. Kontratat e mëvonshme të qirasë prej vitin 2014, me shtetasin L. N. e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit. Po ashtu edhe kontratat me shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi R. B. H., në vitet 2011, 2012 dhe deri në vitin 2014 duket se janë kontrata fiktive të cilat nuk kanë logjikë tregtare dhe as nuk provohet se janë realizuar të ardhura për të cilat të jenë përmbushur detyrimet tatimore.

Trupi gjykues i Komisionit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia kur ka pranuar të shqyrtojë në vitin 2013 procedimin penal për kallëzimin e bërë nga shtetasi L. N. me të cilin kishte pasur një marrëdhënie interesi (huamarrjeje) më herët në vitin 2006, e cila rezultoi e dyshimtë dhe e padeklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

4.20 Shkëmbimi i pasurisë tokë arë me sip. 1.200 m², ndodhur në Bërxullë, fillimisht me detyrimin për shlyerjen në vitin 2010 të vlerës së kredisë së marrë në vitin 2005 ndaj “Emporiki Bank” nga subjekti i rivlerësimit dhe më pas shtuar pasurinë bodrum me sip. 600 m², konsiderohet nga Komisioni në një disproporcionalitet shumë të madh, referuar vlerave përkatëse të pronave të shkëmbyera dhe pa një logjikë ekonomike. Veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në shtimin e pasurive të tij, duket se kryhen në forma të tilla që shmangin tërësisht pagimin e tatimeve për vlerat e super shtuara të pasurisë së tij gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit.

4.21 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe në përputhje me ligjin e se ai nuk ka burime financiare të ligjshme, si dhe gjendet në situatën e konfliktit të interesit të paktën në një rast, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë dhe ndodhet në kushtet e germave “a” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. Pasuria automjet tip “Mercedes Benz **”, me targa ****, e blerë me Kontratën e Shitjes datë 25.9.2004, me palë shitëse shtetasin Pëllumb Tupani, në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, shitur sipas Kontratës nr. **** rep. nr. **** kol., datë 16.1.2010, shtetasit Gj. M. me vlerë 11.000 (njëmbëdhjetë mijë) euro.**

5.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim për pasurinë e mësipërme: të ardhura nga emigracioni (deklaruar në DPV-në e vitit 2004).

5.2 Subjekti deklaron në DPV-në e vitit 2010 shitjen e automjetit sipas Kontratës nr. **** rep., nr. **** kol., datë 16.1.2010, shtetasit Gj. M. me vlerë 11.000 (njëmbëdhjetë mijë) euro. Ai nuk përcjell kontratën e blerjes së automjetit të vitit 2004 dhe DPSHTRr-ja nuk e përcjell dokumentacionin lidhur me këtë automjet si të regjistruar me pronar subjektin e rivlerësimit.

5.3 Nga hetimi në faqen zyrtare të AMF-së rezulton se ky automjet, prej datës 12.2.2008, ka pasur pronar z. Bardhok Lleshi dhe përdorues z. M. Xh.. Të dhënat e vitit 2009 mungojnë për automjetin dhe më tej prej datës 19.8.2010 rezulton pronar shtetasi Gj. M..

5.4 Nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezulton se subjekti ka udhëtuar rregullisht me këtë automjet (me targa ****) si drejtues i automjetit në datat 17.9.2006, 13.8.2009 dhe 3.6.2010.

5.5 Komisioni vlerësoi dokumentacionin që zotëronte lidhur me këtë automjet, nga i cili rezulton se pas pothuajse 6 vjetësh përdorim të automjetit nga subjekti, ai është shitur me vlerë dy herë më të lartë (11.000 euro) se vlera e blerjes (5.000 euro) ose 220 % më shumë.

5.6 Subjekti²⁷, i pyetur nga Komisioni në lidhje me shitjen e automjetit në pothuajse dyfishin e çmimit të blerjes edhe pas 6 vjetësh përdorim, shpjegon se ky automjet është blerë në shumën rreth 8.500 (tetë mijë e pesëqind) euro pa doganë, ku bashkë me zhdoganimin dhe pajisjen me targa, me sa mban mend, ka shkuar afërsisht në shumën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) euro, por shitësi ka kërkuar që në aktin e shitjes të shënohej shuma 5.000 (pesë mijë) euro. Subjekti shpjegon se kjo vlerë është konfirmuar gjatë hetimit penal në kuadër të procedimit nr. ****, të vitit 2014 të kryer nga ILDKPKI-ja në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, por nuk përcjell ndonjë dokumentacion provues.

5.7 Nga hetimi për këtë pasuri ka rezultuar se pagesa për blerjen e automjetit është bërë *cash*. Subjekti ka deklaruar në DPV-të përkatëse çmimin e blerjes së automjetit në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro. Nga të dhënat në Komision rezulton se nuk është bërë pagesa e tatimit mbi fitimin lidhur me shumën e fituar nga shitja e automjetit 6.000 (gjashtë mijë) euro (11.000 – 5.000), referuar kontratave të blerjes dhe asaj të shitjes.

5.8 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me këtë pasuri.

5.9 Subjekti shpjegon se vlera reale e tij për blerjen ka qenë 12.000 (dymbëdhjetë mijë) euro dhe për këtë arsye nuk ka qenë nevoja për pagesë tatimi për diferencën me vlerën e shitjes.

²⁷ Shihni përgjigjen nr. 3 të pyetësorit datë 7.2.2020.

Gjatë shpjegimeve të tij, subjekti nuk përcjell dokumentacion provues për Kontratën e Blerjes së automatit në vitin 2004.

5.10 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të rremë dhe se ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie dhe se ai ndodhet në kushtet e germave “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë “**” sh.p.k.:** (a) në kuotën prej 60 %, në zotërim të subjektit të rivlerësimit z. Bardhok Lleshi, blerë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga emigracioni; (b) në kuotën prej 40 %, në zotërim të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. A. P.. Blerë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna në mësimdhënie pranë Universitetit të Tiranës.

6.1 QKB-ja²⁸ konfirmon se subjekti dhe bashkëshortja e tij janë zotërues kuotash në shoqërinë “****” sh.p.k., përkatësisht me 60 % dhe 40 % të pjesëmarrjes. Shoqëria është regjistruar me vendimin nr. ***, datë 21.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pajisur me NIPT ***. Nga data 30.12.2015 të dy ortakët, bazuar në aktmarrëveshjen datë 30.12.2015, zotërojnë në mënyrë pasive kuotat e tyre në shoqëri, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

6.2 Nga hetimi në faqen zyrtare të QKB-së rezulton se shoqëria tregtare “****” sh.p.k. është regjistruar në datën 21.12.2006, me vendimin nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kapital themeltar 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe ortakë: (1) znj. A. P. (bashkëshortja e subjektit) me zotërim 40 % të kuotave; (2) z. F. Ll. me zotërim 30 % të kuotave (vëllai i subjektit); dhe (3) z. N. M. me zotërim 30 % të kuotave (kunati i subjektit). Administratore e shoqërisë është përcaktuar znj. A. P., deri në dhjetor të vitit 2014.

6.3 Subjekti përcjell në Komision së bashku me deklaratën e pasurisë:

- a) Kontratën²⁹ e Shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.8.2011, të 30 % të kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k., midis palës shitëse N. M. (kunati) dhe palës blerëse Bardhok Lleshi pranë noterit publik Xh. H. Çmimi i shitjes së kuotave të shoqërisë është në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë, i cili është paguar para nënshkrimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale.
- b) Kontratën e Shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.8.2011, të 30 % të kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k., midis palës shitëse F. Ll. (vëllai i subjektit) dhe palës blerëse Bardhok Lleshi para noterit publik Xh. H. Çmimi i shitjes së kuotave të shoqërisë është në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë, i cili është paguar para nënshkrimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale.

6.4 Nga vlerësimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se subjekti nuk i deklaron kuotat e bashkëshortes në shoqërinë tregtare “****” sh.p.k. në vitin e krijimit të tyre, pra në DPV-në e vitit 2006, por i deklaron vetëm në DPV-në e vitit 2008.

6.5 Më 26.5.2010 janë shitur kuotat e filialit (përfaqësisë) në Kosovë të shoqërisë “****” sh.p.k., me Kontratë nr. *** rep. nr. *** kol., nga shoqëria “****” sh.p.k., në vlerën e shitjes 5.000 (pesë mijë) euro, të barabarta me 100 % të kapitalit të zotëruar prej saj. Ortaku i shoqërisë “****” sh.p.k. rezulton³⁰ të jetë z. S. M. (vëllai i subjektit). Duke parë bashkëpunimin e ngushtë midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. duket se midis tyre janë lidhur kontrata, të cilat mund të kenë edhe karakter vetëm formal.

²⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2020, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shihni dosjen ILDKPKI, Aneks ***.

³⁰ Referojuni faqes zyrtare të QKB-së për shoqërinë “****” sh.p.k., NIPT ***.

6.6 Nga verifikimet në internet³¹ duket se këto dy shoqëri (“****” dhe “****”) veprojnë dhe kanë të njëjtin aktivitet/qëllim. Objektet e ndërtimit dhe projektet e investuara përfshirë edhe koncensionet për pasuri publike duket se janë projekte të të dyja shoqërive.

6.7 Në vitin 2011 rezulton të ketë ndryshuar struktura e aksionerëve të shoqërisë, duke u shtuar me 60 % të kuotave të pjesëmarrjes z. Bardhok Lleshi, të blera sipas Kontratave të Shitjes së Kuotave nr. *** dhe nr. **, datë 31.8.2011 nga z. N. M. dhe z. F. Ll. Çmimi i shitjes së kuotave është në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në total, i cili është llogaritur në bazë të pjesëmarrjes së subjektit (60 %) me vlerën nominale të çdo kuote (1.000 lekë) të regjistruar në QKB.

6.8 Subjekti, i pyetur³² nga Komisioni shpjegon se në kohën kur ka blerë aksionet, shoqëria nuk ka pasur asnjë pasuri të regjistruar dhe vlera e kapitaleve të shoqërisë ka qenë 100.000 (njëqind mijë) lekë. Fitimet e saj janë rinvestuar në shoqëri dhe nuk ka pasur dividend të shpërndarë.

6.9 Në QKB rezulton të ketë ndryshuar statusi i ortakëve të shoqërisë sipas aktmarrëveshjes së firmosur në datën 30.12.2015, ku është caktuar z. E. L. (zotërues aktiv i kuotave) në cilësinë e personit të besuar të secilit prej ortakëve Bardhok Lleshi dhe A. P. (zotërues pasiv të kuotave). Kjo aktmarrëveshje është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Në marrëveshje përcaktohet se shtetasit Bardhok Lleshi dhe A. P. i kalojnë z. E. L. tërësisht të drejtën e vendimmarrjes mbi 100 % të kuotave të zotëruara prej tyre në shoqërinë “****” sh.p.k. Pavarësisht sa më sipër, ata vazhdojnë të gëzojnë të drejtën e përfitimit të fryteve të pronësisë që gëzojnë mbi kuotat në shoqëri, të cilat do të jenë të pasqyruara hollësisht në pasqyrat e saj financiare.

6.10 Nga hetimi i pasqyrave financiare prej fillimit të aktivitetit të shoqërisë “****” sh.p.k., nuk rezultoi shpërndarje dividendi tek ortakët e saj.

6.11 DPT³³-ja konfirmon se subjekti tregtar është i regjistruar në sistemin e tyre tatimor dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Ndërkohë përcillet informacion edhe mbi xhiron dhe fitimin e deklaruar nga shoqëria që nga fillimi i aktivitetit deri në vitin 2019. Gjithashtu konfirmohet se në asnjë prej periudhave të aktivitetit nuk është shpërndarë dividend nga shoqëria te zotëruesit e kuotave. Rezultatet vjetore të shoqërisë të deklaruar janë pasqyruar si vijon:

Viti	Të ardhurat (në lekë)	Fitimi i deklaruar (në lekë)
2007	73.460.764	11.593.162
2008	109.182.008	39.475.018
2009	103.938.121	17.822.131
2010	15.562.743	-1.684.580
2011	24.327.954	681.390
2012	117.253.252	32.530.936
2013	147.975.165	43.350.135
2014	966.210	-1.890.019
2015	18.351.206	7.648.852
2016	19.748.750	3.512.951
2017	22.827.138	3.503.722
2018	35.896.741	2.015.116
2019	9.267.938	3.990.567*

³¹ Shihni https://ëëë.century21albania.com/en/property/524885/shitet-apartament-1-1-post-parkimi-në-astir-tek-kompleksi-****-cpm29007.html, https://ëëë.facebook.com/****/photos/****-shpk/2196919243665167/

³² Shihni përgjigjen nr. 2 të pyetësorit datë 7.2.2020.

³³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2020, në dosjen e Komisionit.

*Kjo vlerë është përditësuar nga pasqyrat financiare të deklaruara në faqen e QKB-së.

6.12 Agjencia e Prokurimit Publik³⁴ konfirmon se deri në datën 26.1.2017 shoqëria tregtare apo edhe zotëruesit e kuotave të saj nuk kanë marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi elektronik.

6.13 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, mosdeklarimin nga ai në mënyrë të plotë në deklaratimet periodike vjetore të kësaj pasurie, si dhe të shpjegojë nëse bie ndesh pjesëmarrja e tij në këtë aktivitet tregtar, referuar funksionit të tij si prokuror.

6.14 Subjekti shpjegoi se: “... shoqëria ‘***’ sh.p.k. dhe shoqëria ‘***’ sh.p.k. kanë të njëjtin qëllim për kryerjen e ndërtimeve, mendoj se qëllimi dhe veprimtaria e shoqërisë është e ligjshme dhe kjo nuk përbën shkelje ligjore të asnjë lloji natyre, për sa i përket projekteve të përbashkëta, investimeve të përbashkëta me kontraktim të drejtpërdrejtë apo me nënkontraktim, deri në këtë moment kurrë nuk ka pasur një gjë të tillë, nuk ka pasur as projekt të përbashkët apo financim të përbashkët, shoqëria ‘***’ sh.p.k., nuk ka përfutuar koncension publik asnjëherë gjatë veprimtarisë së saj tregtare, as e vetme, as në bashkëpunim me shoqërinë ‘***’ sh.p.k., apo ndonjë shoqëri tjetër.”

6.15 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këtë pasuri rregullisht në deklaratimet periodike vjetore sipas kërkesave të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, për deklarimin e pasurive, por ai e ka deklaruar të plotë në deklaratën *Vetting*. Pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në një shoqëri tregtare, megjithëse në statusin e tij pasiv, e cila për nga qarkullimi vjetor duket se ka pasur aktivitet të mirë tregtar gjatë ushtrimit prej tij të detyrës së prokurorit, ndërthurja dhe bashkëveprimi i tij në veprimtari të tregtare të vëllëzërve, duket se ka për qëllim ndikimin ndoshta edhe në dukje të figurës së tij si prokuror në veprimtarinë tregtare fitimprurëse të vëllëzërve të tij, duke cenuar me veprimet e tij indirekte besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

6.15.1 Kjo pasuri, sikurse edhe pasuritë e tjera të subjektit të sipërtrajtuara, buron nga të ardhura të deklaruara nga emigracioni e të paprovuara prej subjektit të rivlerësimit, të cilat gjatë ushtrimit të detyrës nga prokurori Bardhok Lleshi duket se janë shtuar duke u shndërruar edhe në këtë rast në një shoqëri tregtare me një vlerë kapitale disa herë më të lartë se ajo e krijimit në vitin 2004 dhe në vlerësim të trupit gjykues në kufijtë e cenimit të detyrës dhe në cenim të thellë të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, qoftë edhe atij në dukje. Pasuritë e krijuara me një burim financiar të deklaruar nga emigracioni, por të paprovuar, duket se gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit janë shtuar dhe shumëfishuar duke e rivlerësuar pasurinë e subjektit në vlera të cilat duket se kanë karakter tregtar dhe se nuk shkojnë përshtat me një funksionar të sistemit të drejtësisë.

6.16 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri rregullisht në deklaratën *Vetting*, por nuk ka provuar lidhur me burimin e ligjshëm të shumës 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për krijimin e saj. Blerja e kuotave të shoqërisë nga subjekti i rivlerësimit, në vitin 2011, në vlerën minimale, me arsyetimin se shoqëria nuk ka pasur asnjë pasuri të regjistruar dhe vlera e kapitaleve të shoqërisë ka qenë 100.000 (njëqind mijë) lekë, nuk duket e arsyeshme pasi vetë shoqëria kishte fitime të konsiderueshme nga aktiviteti i saj tregtar deri në vitin 2011, të cilat ishin riinvestuar në shoqëri duke e rritur kështu vlerën e kapitalit të saj. Kjo në vlerësim të trupit gjykues i bën veprimet e subjektit të rivlerësimit fiktive duke e vendosur atë në kushtet e germave “b” dhe “ç” të pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

GJETJE TË TJERA

7. Pasuria truall ndërtimi me sip. 7.210 m² në Lezhë. Kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting*. Subjekti e deklaroi këtë pasuri në deklaratën fillestare të vitit 2004, pjesa

³⁴ Shihni shkresën nga Agjencia e Prokurimit Publik, dosja ILDKPKI, Aneks ***.

takuese: 0 %, blerë nga vëllai F. Ll. (emigrant). Subjekti deklaron si datë krijimi 2.7.2002 dhe vlerën 3.900.000 (tre milionë e nëntëqind mijë) lekë.

7.1 Në shkresën e ZQRPP³⁵-së në dosjen e ILDKPKI-së të datës 23.10.2017, rezulton se kjo pasuri me sip. 7.210 m² është regjistruar në ZRRPP-në Lezhë me nr. regjistri hipotekor nr. ***, datë 27.5.2002. Kjo pasuri është blerë sipas Kontratës së Shitblerjes së pasurisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.2002, nga z. Bardhok P. Lleshi, palës shitëse shtetasve H. M., O. R., G. R., B. R., A. R., H. K., A. T., të përfaqësuar nga z. B. M.. Çmimi i shitjes së pasurisë është në vlerën 3.950.000 (tre milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës së noterisë.

Pasuria është shitur me Kontratën Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2005, nga pala shitëse Bardhok Lleshi te pala blerëse F. Ll., i përfaqësuar me prokurë nga shtetasi Bardhok Lleshi. Çmimi i pasurisë është në vlerën 3.950.000 (tre milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të likuiduara tërësisht jashtë zyrës së noterisë. Subjekti i rivlerësimit përfaqëson palën blerëse, vëllanë e tij me prokurë, në të cilën deklarohet se ai është me banim në Toronto, Kanada (prokurë pa vulë apostile).

7.2 Gjatë hetimit ka rezultuar një kërkesë nga shtetasi F. Ll., të datës 26.4.2005, për regjistrim si Person Fizik dhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për këtë kërkesë në datën 29.4.2005. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi se pse kjo kontrata e shitjes (firmosur në datën 4.2.2005) nuk u firmos në kohën kur vëllai realizoi edhe veprimet për regjistrim të aktivitetit tregtar (datë 29.4.2005), kohë në të cilën vërtetohet se ai ka qenë në Shqipëri (gati 3 muaj).

7.3 Lidhur me këtë pasuri rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2005 kontratën e shitjes së kësaj prone, vëllait të tij përfaqësuar me prokurë nga subjekti me cilësinë e shitësit. Komisioni ka dyshime se mbi këtë pronë është ndërtuar kompleks banesash.

7.4 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar bindshëm se kjo pasuri nuk i përket atij ose në të kundërt burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

7.5 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: “... e kam deklaruar konform ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, në deklaratën fillestare të fillimit të detyrës që mban datën 24.3.2005, si pasuri e vëllait tim F. Ll., pasuri që është krijuar me të ardhurat e ligjshme të tij nga emigracioni. Nga data 7.2.2009 vëllai im F. Ll. është larguar nga certifikata familjare e imja dhe, për pasojë, nuk ka qenë subjekt i lidhur në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe nuk kam pasur detyrim ligjor për të deklaruar për pronat e tij.

Lidhur me përfaqësimin e vëllait tim F. Ll., besoj se ai ka shfaqur një vullnet të tij pa asnjë cen nëpërmjet dokumentit ligjor të bërë para noterit publik dhe provë më bindëse se kjo nuk mund të ketë. Prokura për të cilën ju disa herë në këtë hetim e citoni (pa vulë apostile) po jua rishpjegoj se prokura nuk ka qenë për ta përfaqësuar në procese gjyqësore, ajo prokurë është administruar në çdo rast nga të gjitha institucionet shtetërore ku unë e kam përfaqësuar vëllain tim F. Ll..

Mendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se kontrata e shitjes së kësaj pasurie është bërë në datën 4.2.2005 dhe nuk është bërë në datën 29.4.2005, kohë kur vëllai F. Ll. ka qëndruar për rreth tre muaj në Shqipëri është vetëm një mendim dhe nuk përbën provë, në të kundërt të mendimeve të Komisionit unë kam paraqitur prokurën e posaçme të vëllait tim F. Ll., i cili nëpërmjet saj më ka autorizuar të kryej të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me interesat e tij financiare në Republikën e Shqipërisë dhe kjo është një provë shkresore e pakontestueshme që nuk ka mendim që mund ta hedhë poshtë.

*Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ngre dyshime se mbi sipërfaqen e pronësisë truall ndërtimi me sipërfaqe 7.210 m² shoqëria ‘***’ sh.p.k. me NIPTI-*** dhe shoqëria ‘***’ sh.p.k.,*

³⁵ Shihni Aneks ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

referuar bashkëpunimit të ngushtë të tyre mund të kenë ndërtuar kompleks ndërtesash mbi këtë sipërfaqe, gjë e cila jo vetëm nuk është e vërtetë, por është një shpifje, pasi asnjëra prej shoqërive të sipërcituara nuk kanë lidhur asnjë kontratë dhe nuk ka asnjë lloj interesi pasuror mbi atë sipërfaqe pronësie.

Lidhur me pretendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se në deklaratën e vitit 2005 nuk kam deklaruar kontratën e shitjes, po ju shpjegoj se në vitin 2005 jam bërë subjekt i deklaratës së pasurisë, konkretisht, në datën 24.3.2005 kam bërë deklaratimin fillestar të pasurisë dhe në atë kohë sipërfaqja e sipërcituar e pronësisë ka qenë në pronësi të vëllait tim F. Ll. dhe, si e tillë, është deklaruar në deklaratat periodike çdo ndryshim i pronës pas deklaratës fillestare të pasurisë si do të deklaroja unë pakësim prone të paluajtshme për një pronë që unë nuk e kisha në pronësi, pra ky pretendim i juaji nuk qëndron. Konfondimi i deklaratës fillestare të pasurisë me deklaratën periodike vjetore të të njëjtit vit është përmendur në mënyrë të vazhdueshme nga ana juaj si shkelje, por në të vërtetë ato janë të ndryshme.”

7.6 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratë të pasaktë lidhur me këtë pasuri dhe se nuk ka mundur të provojë mundësitë financiare për blerjen e saj, si dhe burimin e ligjshëm të tyre e se ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

8. Pasuria dyqan me sip. 86 m², ndodhur në Rr. “**”. Subjekti e deklaroi të blerë në vitin 2002 nga vëllai F. Ll., me vlerë 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) USD. Pjesa takuese: 0 %.**

8.1 Kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratimin fillestar të vitit 2004 dhe as në deklaratën *Vetting*. Në DPV-në e vitit 2006 subjekti deklaroi të ardhura nga dyqani i vëllait F. Ll., të cilin e menaxhonte personalisht dhe merr fitimet e tij, të deklaruara për këtë vit në shumën 2.800.000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë.

8.2 Subjekti ka shpjeguar në pyetësorët e Komisionit se pronat janë të financuara nga vëllai i tij F. Ll., nga të ardhurat e tij nga emigracioni në SHBA dhe Kanada. Fakti i regjistrimit në emrin e subjektit është se në atë kohë vëllai i tij ka qenë në njëjtën certifikatë familjare dhe nuk ka qenë në Shqipëri në momentin e regjistrimit të pasurisë.

8.3 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar se kjo pasuri nuk i përket atij ose në të kundërt, burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, si dhe të provojë me dokumentacion ligjor përfitimin e të ardhurave të deklaruara dhe pagimin e tatimit.

8.4 Subjekti ka sqaruar në vijim të rezultateve të hetimit se kjo është pronë e vëllait të tij F. Ll. dhe se nuk ka pasur detyrim ligjor të deklarojë kontratën e sipërmarrjes.

8.5 Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë mundësitë financiare për krijimin e kësaj pasurie, po ashtu nuk provohet me ndonjë dokumentacion ligjor se kjo është pasuri e vëllait të tij. Lidhur me përdorimin nga subjekti i rivlerësimit të kësaj pasurie, si dhe deklaratën mbi të ardhura të përfituara prej tij nga menaxhimi i këtij aktiviteti duke marrë fitimin, mbetën të paprovuara dhe tërësisht informale. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germave “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

9. Lidhur me aktivitetin bar-kafe “**” sh.p.k., subjekti deklaroi në deklaratën e pasurisë *Vetting* të ardhura për vitet 2006, 2007 dhe 2008 nga aktiviteti tregtar, të cilat kanë qenë në shumën totale prej 10.300.000 (dhjetë milionë e treqind mijë) lekësh. Subjekti ka përcjellë dokumentacion si vijon: (a) Prokurë e Përgjithshme datë 31.12.2004, sipas së cilës shtetasi F. Ll. emëron përfaqësues z. Bardhok Lleshi, që të veprojë në emrin e tij në çdo veprim ligjor që ka lidhje me administrimin e pasurive të tij të paluajtshme, llogaritë bankare apo çdolloj veprimi tjetër të përfaqësimit që ai shikon të arsyeshme; (b) Deklaratë Noteriale nr. ****, datë 6.1.2017, sipas së cilës shtetasi F. Ll. ka deklaruar se ka autorizuar vëllain e tij Bardhok Lleshi të menaxhojë dhe të marrë të gjitha fitimet e bar-kafe “****” për vitet 2006, 2007 dhe 2008.**

9.1 Sipas faqes zyrtare të QKB-së rezulton se në emër të shtetasit F. Ll. është regjistruar aktiviteti “bar-restorant, tregtim me pakicë të artikujve të ndryshëm”, me status aktiv dhe NIPT ***. Aktiviteti tregtar është i regjistruar si Person Fizik në emër të shtetasit F. Ll., me vendim datë 29.4.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vendi i ushtrimit të aktivitetit është regjistruar adresa: Rr. “****”, Tiranë dhe ky aktivitet rezulton ende me status “aktiv”.

9.2 DRT-ja³⁶ Tiranë konfirmon se shtetasi F. Ll. është regjistruar si Person Fizik me NIPT ***, me aktivitet bar-kafe me emrin tregtar “****”, me adresë aktiviteti: Rr. “****”, nën përgjegjësinë tatimore biznes i vogël. Të ardhurat e deklaruar për këtë aktivitet janë:

Viti	Të ardhurat (në lekë)	Fitimi i deklaruar (në lekë)
2005	2.166.000	0
2006	5.000.000	0
2007	0	0
2008	3.050.000	1.108.632
2009	3.177.700	932.220

9.3 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për t’i provuar se kjo pasuri nuk i përket atij ose në të kundërt burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Subjekti duhet të provojë përfitimin e të ardhurave të deklaruar dhe pagimin e tatimit përkatës për to.

9.4 Në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit subjekti ka parashtruar: “... unë si subjekt deklarimi kam deklaruar të ardhura nga aktiviteti bar-kafe ‘****’ për vitet 2006, 2007 dhe 2008, në shumën prej 10.300.000 lekësh, për një aktivitet i cili ka qenë në emër të vëllait tim F. Ll., i cili më ka autorizuar me një prokurë të posaçme që të përfaqësojë të gjitha interesat pasurore të tij në Republikën e Shqipërisë, prokurë të cilën e kam paraqitur në të gjitha institucionet ku ka kryer veprime dhe jua ka paraqitur dhe juve. Ky aktivitet privat ka qenë një biznes i vogël dhe detyrimet tatimore të tij për kohën kur unë kam pasur tagrin të administroj fitimet e tij ka pasur taksa fikse vjetore dhe fitimi ka qenë me deklarim në fillim të vitit si i parashikuar. Sigurisht, ky lloj aktiviteti tregtar ka funksionuar në bazë të xhiros së përgjithshme vjetore, që për kohën ka qenë deri në 8.000.000 për t’u konsideruar biznes i vogël, mbi atë shumë në mënyrë automatike futej te biznesi i madh, pra dua të sqaroj se ato kanë qenë fitimet reale të deklaruar prej meje.

Ju në raport keni dërguar një tabelë ku përshkruan të ardhurat dhe fitimet nga e cila konstatoj parregullsi të organeve që kanë pasur detyrimin ligjor që të kryejnë detyrën në lidhje me këtë aktivitet dhe ndonëse aktiviteti është regjistruar dhe ka filluar punë që në vitin 2005 deri në vitin 2007 nga organet tatimore nuk ka të dhëna për fitimet e këtij aktiviteti, ndërsa në vitet 2008 dhe 2009 ka të dhëna për fitimet e realizuara, konkretisht: në vitin 2005 të ardhurat janë 2.166.000 (dy milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) ndërsa fitimi është zero; në vitin 2006 të ardhurat janë 5.000.000 (pesë milionë) lekë, ndërsa fitimi është zero; në vitin 2007 të ardhurat zero fitimi zero; në vitin 2008 - 1.108.632 (një milion e njëqind e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë dy) lekë; dhe në vitin 2009 - 932.220 (nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet) lekë, pra është shumë e qartë se kur vetë organet tatimore përgjegjëse kanë të dhëna jo të sakta, ato i kërkonin tek unë që kam qenë një person që kam pasur si detyrë të administroj të ardhurat.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pavarësisht faktit se ligji i kohës për tatimet në Republikën e Shqipërisë e ka të përcaktuar taksimin e biznesit të vogël, më kërkon nëse unë kam paguar taksa mbi fitimet e realizuara, pra kërkon tatim-fitimi mbi individin, gjë e cila nuk ka qenë e parashikuar në kohën kur kam administruar të ardhurat e këtij biznesi të vogël, Komisioni shkon dhe më tej, ku nga njëra anë më kërkon llogari për të ardhurat e këtij biznesi, nga ana tjetër nuk ka njohur asnjë të ardhur të tij në analizën financiare të kryer, përfshi edhe ato të dokumentuara nga organet tatimore.

³⁶ Shihni në dosjen e ILDKPKI-së, Aneks ****, komunikim me anë të postës elektronike datë 26.4.2019.

Dua të sqaroj gjithashtu se nga të ardhurat e këtij aktiviteti janë kryer pagesa për kredinë prej 55.000 euro, të cilën kam marrë pranë 'Emporiki Bank' në fundin e vitit 2005 nga familjarët e mi, të cilët kanë punuar dhe administruar këtë aktivitet tregtar.

Në lidhje me këtë aktivitet po ju vë në dispozicion si provë deklaratat noteriale të të afërmeve të mi të cilët kanë kryer pagesat e kredisë për kohën që unë kam pasur tagrin të administroj të ardhurat e këtij biznesi të vogël."

9.5 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit, vërehet se ajo ndodhet në të njëjtin pallat ku ndodhet edhe banesa e subjektit të rivlerësimit. Sipas deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit ligjor lidhur me këtë aktivitet, ajo është deklaruar si një pasuri e vëllait të tij e investuar tërësisht prej tij dhe e regjistruar në emër të tij. Mbështetur në dokumentin "Prokurë e Përgjithshme datë 31.12.2004", shtetasi F. Ll. emëron përfaqësues z. Bardhok Lleshi, që të veprojë në emrin e tij në çdo veprim ligjor që ka lidhje me administrimin e pasurive të tij të paluajtshme, llogaritë bankare apo çdolloj veprimi tjetër të përfaqësimit që ai shikon të arsyeshme, çka do të thotë se subjekti duhet të veprojë në emër dhe për llogari të vëllait të tij. Dokumenti Deklaratë Noteriale nr. ***, datë 6.1.2017, e realizuar në vitin 2017 nuk mund të ketë vlerë provuese për veprime të kryera në vitet 2006, 2007 dhe 2008, dhe për më tepër duket se është kryer në kuadër të plotësimit të deklaratës *Vetting* për të justifikuar të ardhura të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara prej tij jo në formën e duhur ligjore.

Po ashtu, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk është e qartë mënyra se si ai i ka përfituar këto të ardhura nga aktiviteti, për shkak se e ka menaxhuar atë duke përfituar një pagesë mujore apo duke përfituar të ardhurat nga fitimi i realizuar nga ky aktivitet. Gjithashtu, lidhur edhe me qarkullimin dhe fitimin e deklaruar për këtë aktivitet, subjekti nuk paraqiti ndonjë provë që të kundërshtonte të dhënat e DRT-së Tiranë.

9.6 Për sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit ka menaxhuar një aktivitet tregtar për të cilin nuk është deklaruar me transparencë marrëdhënia e tij në këtë aktivitet dhe mënyra e përfitimit të të ardhurave të deklaruara, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushte të tilla që ngrenë dyshime të arsyeshme se kjo është një pasuri e fshehur e tij ose së paku aktiviteti tregtar nga i cili ai ka përfituar të ardhura është një veprimtari e subjektit të rivlerësimit për të cilën ai ka bërë deklaram të rremë dhe për të cilën janë përfituar të ardhura, që nuk përmbushin kërkesat e nenit D, paragrafi 3, i Aneksit të Kushtetutës.

9.7 Nga vlerësimi në tërësi i kësaj pasurie, e cila rezulton e blerë para fillimit të detyrës me burime të panjohura dhe të paprovuara, janë deklaruar të ardhura të përfituara për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë ligjshmërinë e tyre. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germave "b", "c" dhe "ç", të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

10. Pasuria tokë arë me sip. 1.000 m², me vendndodhje në Gojan të Madh, Pukë, me nr. pasurie ***, e përfituar me ligjin nr. 7501, e regjistruar në datën 4.6.2018. Nga shkresat³⁷ e ASHK-së rezulton se kjo sipërfaqe toke është përfituar sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 8.7.1992, ndërsa subjekti e deklaroi në DPV-në e vitit 2018.

10.1 Në lidhje me vonesën në deklarimin e pasurisë, subjekti, i pyetur³⁸ gjatë hetimit, shpjegon se: *"... kjo pasuri është deklaruar në momentin që jam pajisur me certifikatë pronësie. Arsyeja e pajisjes me certifikatë pasurie pas kaq kohësh është sepse zona ku ndodhet kjo pronë nuk ka qenë e futur në sistem nga Kadastra e Rrethit Pukë."*

10.2 Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit.

11. DPSHTRr-ja³⁹ konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit rezulton automjeti me targa ***, i cili mban statusin "i çregjistruar". Nga dokumentacioni i përcjellë rezulton se me

³⁷ Shihni shkresat nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 6.2.2020 dhe datë 14.2.2020, në dosjen e Komisionit.

³⁸ Shihni përgjigjen nr. 8 të pyetësorit datë 9.4.2020.

³⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2020, në dosjen e Komisionit.

Kontratën e Shitjes të nënshkruar në datën 17.12.1994, automjeti i është shitur shtetasit Agron Malo me çmimin 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Ky automjet është futur në Doganën e Durrësit në datën 5.1.1995 dhe në datën 23.6.1997 i është shitur shtetasit Bardhok Lleshi me çmimin 400.000 (katërqind mijë) lekë.

11.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të datës 29.3.2012 se ky automjet është vjedhur në vitin 1999, prandaj kërkon çregjistrimin e saj.

11.2 Subjekti shpjegon se: *“Në lidhje me automjetin kam për të shpjeguar se unë e kam pasur në pronësi këtë automjet nga viti 1997 deri në vitin 1999 kur më është vjedhur në qytetin e Tiranës, për të cilin kam bërë kallëzim penal në Komisariatin nr. 1 të Tiranës, i vetmi shpjegim që kam dhënë unë për këtë mjet është në vitin 2016, me sa më kujtohet para deklaratës Vetting kur jam pyetur nga ILDKPKI-ja, ku ju kam sqaruar se ky mjet më është vjedhur në vitin 1999, çregjistrimi i këtij automjeti është bërë në mënyrë të pavarur nga DRSHTRr-ja Tiranë.”* Subjekti nuk ka përcjellë dokumentacion provues.

11.3 Komisioni nuk ngriti dyshime mbi këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit.

12. Kuotat në zotërim të subjektit dhe bashkëshortes në shoqërinë tregtare “**” sh.p.k.**

12.1 QKB⁴⁰-ja konfirmon se subjekti dhe bashkëshortja, znj. A. P., kanë qenë zotërues të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***, respektivisht me 50 % dhe 25 % të pjesëmarrjes. Nga hetimi në faqen zyrtare të QKB-së rezulton se kjo shoqëri është regjistruar në datën 21.3.2002, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me seli në Rr. “****”, me objekt “Ndërtime civile dhe ekonomike, restaurime, prodhime materiale ndërtimi, etj.”. Ortakët e shoqërisë janë shtetasit Bardhok Lleshi dhe M. Ll. (vëllai i subjektit) me zotërim 50 % të kuotave të saj. Administratori përcaktohet Bardhok Lleshi. Në datën 2.4.2004, me vendim gjykate, largohet nga administrator z. Bardhok Lleshi dhe i shiten 25 % të kuotave të tij shtetasit N. Ll. (vëllai i subjektit). Ndërsa në datën 3.3.2005, me vendim gjykate transferohen kuotat e z. Bardhok Lleshi te bashkëshortja e tij A. P.. Në vitin 2006 ndryshohet selia e shoqërisë në lagjen “****”, Rr. “****”, Lezhë. Me vendim gjykate, në datën 12.4.2007, miratohet largimi i ortakes A. P. dhe transferimi i kuotave të z. N. Ll. (vëllai i subjektit).

12.2 Kjo shoqëri tregtare vazhdon të jetë me status aktiv dhe aktualisht vazhdon të jenë zotërues të kuotave shtetasit D. dhe N. Ll. me 50 % të pjesëmarrjes (vëllezërit e subjektit).

12.3 Nga vlerësimi i dokumentacionit duket se selia e shoqërisë përkon me adresën e subjektit të rivlerësimit, deri në vitin 2006. Në dokumentacionin e regjistrimit rezulton se ortaku D. Ll. ka pasur emrin M. Ll., i cili është ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 17.4.2002, të Komunës Gjegjan.

12.4 Subjekti⁴¹, i pyetur gjatë hetimit në lidhje me mosdeklarimin e kuotave të tij dhe bashkëshortes në këtë shoqëri tregtare, shpjegoi: *“... ato janë shitur përpara se të bëhej subjekt deklarimi, pra në datën 3.3.2005, ndërsa në lidhje me bashkëshorten konstatimi i Komisionit qëndron, por ka ndodhur për shkak të neglizhencës dhe padijenja e saj dhe nuk ka pasur si qëllim fshehjen, pasi shoqëria në atë kohë sa ka filluar aktivitetin dhe nuk ka pasur asete të krijuara.”*

12.5 Në vijim të shpjegimeve të subjektit, rezulton se ai ka qenë subjekt deklarues në tetor të vitit 2004, pra kur ende zotëronte kuotat e shoqërisë “****” sh.p.k. Në lidhje me shpjegimin e subjektit lidhur me bashkëshorten e tij, nga vlerësimi i dokumenteve ka rezultuar se shoqëria tregtare ka pasur aktivitet me fitim për periudhat kur ajo zotëronte aksione të saj (vitet 2006 - 2007), ndaj dhe mungesa e deklarimit nuk mund të konsiderohet vetëm formale apo nga neglizhenca.

12.6 Nga pasqyrat financiare të deklaruara dhe të publikuara në faqen zyrtare të QKB-së rezulton se shoqëria ka realizuar në vitet 2006 - 2007 rezultatet si vijon:

⁴⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2020, në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Shihni përgjigjen nr. 6 të pyetësorit datë 7.2.2020.

Viti	Të ardhurat (në lekë)	Fitimi i deklaruar (në lekë)
2006	40.028.898	2.733.380
2007	110.478.713	10.393.076

12.7 Në përfundim, nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklarin para fillimit të detyrës (2004) kuotat e zotëruara prej tij në shoqërinë tregtare “****” sh.p.k.; nuk e deklaroi në deklarin vjetor të vitit 2005 transferimin e kuotave të bashkëshortja e tij A. P., zotërimin e kuotave prej saj me cilësinë e personit të lidhur dhe as fitimin e realizuar të shoqërisë; nuk e deklaroi në deklarin vjetor të vitin 2007 largimin nga shoqëria të bashkëshortes duke transferuar kuotat të vëllai i tij. Këto veprime duket se kanë pasur për qëllim fshehjen e kësaj pasurie dhe veprimtarisë së saj tregtare.

12.8 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit për këtë pasuri.

12.9 Në parashtrimet e tij, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i aksioneve të bashkëshortes është një shkelje që është bërë prej saj nga neglizhenca dhe nuk ka pasur qëllim fshehjen e kuotave, ndërsa për fitimet e shoqërisë shpjegon se shoqëria nuk ka shpërndarë dividend dhe vlera e aksioneve të transferuara nga bashkëshortja të kunati janë vetëm 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

12.10 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit çmon se subjekti i rivlerësimit, duke mos deklaruar këtë pasuri në deklarinet periodike, i është shmangur njëkohësisht edhe kontrollit edhe verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve të kryera prej tij, si dhe të vetë shoqërisë tregtare. Ai deklaroi se shoqëria nuk ka shpërndarë fitimin, duke e rikapitalizuar brenda saj, por ndërkohë thotë se bashkëshortja e tij i ka shitur kuotat e saj në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë. Në bindjen e trupit gjykues, veprimet e subjektit të rivlerësimit për kalimin e kuotave të bashkëshortja dhe, më tej, shitja e tyre në vitin 2007 edhe prej bashkëshortes, janë veprime fiktive të kryera për të shmangur kontrollin dhe verifikimin e kësaj pasurie apo veprimtarinë e subjektit dhe të personit të lidhur me të në kushtet e konfliktit të interesit.

12.11 Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germave “c” dhe “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

13. DPPP-ja⁴² ka raportime të transaksioneve bankare nga znj. A. P. si vijon:

- a. në datën 19.8.2009 në “ProCredit Bank” ka depozituar në llogarinë e saj shtetasi V. M. T., me përshkrim “pagesë kësti blerje apartamenti” në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro;
- b. në datën 22.5.2014 në “Bankën Kombëtare të Greqisë” ka tërhequr nga llogaria shumë 30.690 (tridhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) euro;
- c. në datën 3.6.2014 në “Bankën Kombëtare të Greqisë” ka tërhequr nga llogaria shumë 9.990 (nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) euro.

13.1 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar lidhur me veprimet e kryera nga personi i lidhur, bashkëshortja, të cilat nuk gjenden të deklaruara në deklarinet periodike vjetore përkatëse.

13.2 Në parashtrimet e tij, subjekti shpjegon: “Lidhur me raportimin e datës 19.8.2009 mbi depozitimin e vlerës prej 25.000 euro me objekt pagese kësti për blerje apartamenti është e qartë se arsyeja e këtij depozitimi është në kuadër të veprimtarisë së shoqërisë ‘***’ sh.p.k. dhe nuk ka lidhje me veprimtari individuale të znj. A. P. si subjekt i lidhur me deklaruesin. Ky fakt vërtetohet edhe me kalimin e pronësisë së apartamentit në vitin 2015 të djali i porositësit V. M. T., bashkëlidhur po ju dërgoj dhe aktin noterial përkatës.

Lidhur me raportimin e datës 22.5.2014, ku në Bankën Kombëtare të Greqisë ka tërhequr vlerën prej 30.690 euro dhe atë të datës 3.6.2014, ku ka tërhequr vlerën prej 9.990 euro dhe, në këtë rast, ka të bëjë me blerje apartamenti, ku një klient pasi ka marrë kredi për blerjen e

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2020.

*apartamentit banka i ka kaluar në llogarinë personale të administratores së shoqërisë ‘***’ sh.p.k. znj. A. P. dhe në vijimësi janë tërhequr për nevojat e shoqërisë, të cilat janë të gjitha të pasqyruara në bilanci përkatëse vjetore të aktivitetit të shoqërisë.”*

13.3 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar me vërtetësi dhe saktësi në deklaratimet e tij periodike vjetore, e se ai gjendet në kushtet e gërmës “a” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

14. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në deklaratën e pasurisë *Vetting* të plotësuar në datën 26.1.2017, deklaroi se gjendja e kursimeve është në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro, ndërsa në DPV-në e vitit 2016, e cila është plotësuar në datën 20.3.2017, deklaroi se kursimet për vitin 2016 janë në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, të cilave duke iu shtuar edhe gjendja e kursimeve të vitit 2015 në vlerën 7.661.674 (shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë rezulton me një total prej 8.338.024 (tetë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e njëzet e katër) lekësh të kursimeve në fund të vitit 2016.

14.1 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar lidhur me mospërputhjen e vlerës së kursimeve të deklaruara në deklaratën e pasurisë me gjendjen e tyre sipas DPV-së së vitit 2016.

14.2 Në parashtresën e tij, subjekti shpjegon: *“Lidhur me pretendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se gjendja e kursimeve të deklaruara në DPV deri në vitin 2015 dhe të tjerat më vonë rezultojnë me një total prej rreth 8.338.024 (tetë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e njëzet e katër) lekësh të kursimeve në fund të vitit 2016, kam për të shpjeguar se deklaratimet e mia kanë qenë gjithmonë të sakta të deklaruara sipas akteve përkatëse noteriale, fakti që këto të ardhura nuk do të thotë se ato duhet të jenë në gjendje cash, të ardhurat janë për t’u shpenzuar, ato nuk janë të detyrueshme për t’u deklaruar, me përjashtim të rastit kur me to krijohet një pasuri, e luajtshme, e paluajtshme, llogari bankare apo përdoren për shkollim. Në rastin konkret megjithëse kam pasur të ardhura nuk kam abuzuar me krijimin e pasurive fiktive.”*

14.3 Shpjegimet e subjektit nuk përputhen me deklaratimet e tij dhe nuk janë bindëse për Komisionin. Në vlerësim të deklarimeve periodike vjetore të subjektit, si dhe deklarimit *Vetting* lidhur me gjendjen *cash* arrihet në konkluzionin se deklarimet e subjektit mund të jenë fiktive, duke mos pasqyruar situatën reale të kursimeve të tij në fund të çdo viti, e duke e vendosur atë në kushtet e gërmës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

ANALIZA FINANCIARE

15. Komisioni, kreu analizën financiare bazuar në: dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; deklaratat e interesave pasurore private/vjetore; deklaratën *Vetting*; pyetësorët me përgjigjet e subjektit; si dhe korrespondenca e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike.

15.1 Rezultati⁴³ i analizës financiare për subjektin e rivlerësimit, z. Bardhok Lleshi, për periudhën 2004 – 2016 rezultoi në vlerë negative prej -10.578,153 (dhjetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë. Në këtë rezultat nuk është pasqyruar vlera e kështit prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro për blerjen e apartamentit me sip. 124.1 m², ndodhur në Rr. “***”, Tiranë (porositur në vitin 2003 dhe regjistruar datë 6.11.2012).

Rezultati i analizës financiare përpara vitit 2004, rezulton në një bilanci negativ në vlerën prej -11,185,619 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

Në total analiza financiare rezulton në vlerën negative prej - 21,763,772 (njëzet e një milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind shtatëdhjetë e dy) lekë.

⁴³ Për më shumë informacion referojuni analizës financiare të detajuar të Komisionit.

15.2 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës provës për të provuar të kundërtën e rezultatit negativ, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave në përputhje me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

15.3 Në vijim të pretendimeve të subjektit për tu përfshirë në analizën financiare fitimet/të ardhurat nga aktiviteti bar-kafe “****”, Komisioni çmon se referuar deklarimeve të subjektit, si dhe prokurës së lëshuar nga vëllai i tij (trajtuar më lart në këtë vendim), ato janë të ardhura të vëllait të tij (dhe jo të subjektit), e se subjekti i rivlerësimit administronte për llogari të vëllait të tij, të ardhurat dhe pasuritë e tij, dhe se për ato nuk u dokumentua në ndonjë mënyrë se ishin përfituar prej tij e se për to ishin paguar detyrimet tatimore përkatëse, ndaj nuk mund të konsiderohen si të ardhura në analizën financiare.

15.4 Në lidhje me pretendimet e subjektit se nga Komisioni janë llogaritur shpenzime jetese më të larta se ILDKPKI-ja edhe pse janë mbështetur të dy (institucionet) në të njëjtën bazë referuese (INSTAT) sqarohet se shpenzimet jetike të llogaritura nga Komisioni janë në vlerë totale 7.511,386 (shtatë milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, ndërsa shpenzimet e llogaritura nga ILDKPKI-ja janë në vlerë totale 8.000.000 (tetë milionë) lekë. Pretendimi i subjektit se shpenzimet e jetesës të llogaritura nga Komisioni janë në vlerë 9.600.000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë nuk qëndrojnë.

15.5 Në parashtrimet e tij subjekti ka përcjellë vërtetimet e lëshuara nga ISSH Lezhë për vitet 2007 – 2020, të cilat nuk disponoheshin më parë nga Komisioni. Nga këto vërtetime rezulton se znj. A. P. ka pasur pagë si administratore në shoqërinë “****” sh.p.k. prej qershorit të vitit 2007, për të cilën janë paguar sigurimet shoqërore.

Pas paraqitjes së vërtetimit të ISSH Lezhë⁴⁴, nga Komisioni, u konsiderua në analizën financiare vlera shtesë e të ardhurave të bashkëshortes prej +3.360.492 (tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

15.6 Pas prapsimeve të subjektit të rivlerësimit, rezultati i analizës financiare për vitet 2004 – 2016 ndryshon në vlerën negative prej -8.152.293 (tetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh dhe para vitit 2004 në vlerën prej -11.185.619 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

25. Trupi gjykues i Komisionit, në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, arriti në konkluzionin se provat kanë nivelin e provueshmërisë dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit.

26. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se pasuritë e subjektit të rivlerësimit janë krijuar fillimisht me të ardhura të deklaruara para fillimit të detyrës për të cilat ai nuk ka mundur të provojë burimin e ligjshëm të tyre. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të provuar vërtetësinë e tyre qysh me plotësimin e deklaratës *Vetting* dhe kërkesa e tij për pamundësi objektive gjatë dërgimit të rezultateve të hetimit duket e paarsyeshme dhe jobindëse për Komisionin. Nga ana tjetër, në një vlerësim tërësor që i bëhet të gjitha pasurive të subjektit të rivlerësimit konstatohen pasaktësi të qëllimshme në deklaratet periodike vjetore, si dhe marrëveshje tregtare të kryera prej tij ndër vite, të cilat përveçse nuk janë pasqyruar me transparencë e krijojnë hije dyshimi, duket se kanë shumëfishuar pasuritë e subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së tij si prokuror duke krijuar kështu pasuri të vëna gjatë detyrës në vlera të konsiderueshme dhe pa një dokumentacion ligjor mbështetës mbi ligjshmërinë e tyre.

27. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se pasuritë e tij janë krijuar të gjitha para ushtrimit të detyrës nuk qëndrojnë, pasi pasuritë aktuale të tij gjatë rivlerësimit janë disa herë më të mëdha se ato të deklaruara në vitin 2004. Po ashtu pasuritë e fituara para fillimit të detyrës datojnë (sipas dokumentacionit ligjor) mes viteve 2002 – 2004, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit ka qenë student magjistrat dhe se ato nuk mund ta përjashtojnë atë nga përgjegjësia dhe kontrolli. Nga interpretimi i dispozitave të ligjeve të paketës për reformën në drejtësi, por

⁴⁴ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 3.12.2020, të ISSH-së.

edhe nga praktika tanimë e unifikuar prej Kolegjit të Posaçëm të Apelit, arrihet në konkluzionin se standardi i vendosur në kuadër të kësaj reforme, në lidhje me verifikimin e pasurive të trupës së magistratëve, kërkon kontrollin e plotë të pasurive të deklaruara, qofshin këto të krijuara para apo pas emërimit në detyrë të magistratit, për sa kohë, referuar dispozitave të ligjit për statusin e magistratit, verifikimit të plotë të pasurive, sipas të njëjtave standarde të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm për kontrollin dhe deklarimin e tyre, i nënshtrohen edhe kandidatët për t'u pranuar në formimin fillestar të Shkollës së Magistraturës, si dhe të diplomuarit prej kësaj shkolle para emërimit të tyre si magistratë gjyqtarë/prokurorë.

28. Mungesa e vëmendjes dhe vlerësimit ndaj pasurive në pronësi apo përdorim të subjektit të rivlerësimit, të përfituara në shkelje të detyrimeve ligjore, me argumentin që përfitimi i tyre i referohet një periudhe të ndryshme kohore nga ajo e ushtrimit të detyrës nga subjekti, cenon procesin e rivlerësimit, pasi qëllimi i tij do të bëhej i vështirë për t'u përmbushur dhe vlerësimi i pasurive të krijuara në vijimësinë e tyre do të ishte i pamundur. Për më tepër që gjatë hetimit nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit i ka shumëfishuar disa herë pasuritë e tij gjatë ushtrimit të detyrës, origjina e të cilave mbetet e paprovuar dhe e përfituar në shkelje të detyrimeve ligjore.

29. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij, në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

30. Trupi gjykues i Komisionit, nga vlerësimi në tërësi i gjithë pasurisë së subjektit të rivlerësimit, arrin në konkluzionin se ai ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe se gjendet gjithashtu në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bardhok Lleshi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 15.1.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku